



RAPORT MONITORIMI JANAR – MARS 2020

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË

www.drejtesia.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

I. Përmbledhje ekzekutive mbi monitorimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë dhe Planit të Veprimit 2019 – 2021, për periudhën Janar – Mars 2020.....	4
a. Përmbledhje ekzekutive mbi reformën e sistemit të drejtësisë	7
II. Metodologjia e monitorimit	21
III. Disbursimi financiar	22
IV. Progresi i zbatimit sipas objektivave	24
Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.....	24
Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.	25
Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.	26
Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.....	27
Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.	28
Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.....	29
Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.....	30
Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.	31
V. Arritjet kryesore gjatë periudhës Janar – Mars 2020.....	32
VI. Konkluzione.....	35
VII.Sfidat.....	35
Aneks – Plani i Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë.....	36

LISTA E SHKURTIMEVE

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASHSGJ	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
DHKNd	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterëve
DHKPGJP	Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësor Privat
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
KLJGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHKBB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve
SHP	Shërbimi i Provës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2019 – 2021, PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2020.

Reforma në Drejtësi ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj. Institucionet të cilat operojnë në sistemin e drejtësisë janë angazhuar plotësisht, për të pasur një sistem në përputhje me standardet që një vend në pritje të hapjes së negociatave duhet të ketë dhe duhet të realizojë.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 773, datë 2.11.2016, ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit. **Misioni** i kësaj strategjie është zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Ky dokument përmban *tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë*, të cilat janë:

1. Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
2. Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.
3. Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
4. Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
5. Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
6. Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.
7. Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë.
8. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Përsa më sipër, në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e Planit të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën 2019 - 2021. Për këtë qëllim, u hartua Pasaporta e Indikatorëve, në funksion të objektivave të strategjisë. Në muajin qershor, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 409, datë 19.06.2019 ka miratuar Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Metodologjia e ndjekur në rishikimin e Planit të Veprimit ishte përfshirja e të gjithë institucioneve përgjegjëse, të identifikuar në Planin e Veprimit të mëparshëm, marrja e kontributeve dhe parashikimeve të tyre direkte në hartim dhe zbatim të masave. Masat e parashikuara janë ideuar mbi bazë rezultati konkret, të matshëm dhe janë të kostuara. Gjatë parashikimit të masave u aplikua ndërlidhja *objektiv-indikator-masë*. Objektivat e Strategjisë janë organizuar dhe ndarë në nën-objektiva për të bërë të mundur një organizim më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë të masave të parashikuara dhe të lidhura me to. Është aplikuar formati i parashikimit të masave me target/milestones.

Masat e reja të Planit të Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë synojnë të intensifikojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të reja në drejtësi, si KLGJ, KLP, ILD, KED, të SPAK e Gjykatës së Posaçme (GJKKKO), të thellojnë formimin tekniko-profesional të sistemit të drejtësisë nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve e administratës gjyqësore apo dhe rritjen e aksesit në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të Ndhmës Juridike Falas.

Plani i Veprimit 2019-2021, i jep një hov zhvillimi përmirësimit të gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe të tjera përmirësime në infrastrukturë. Organet e reja në drejtësi parashikohen të jenë të pajisura me kushte dhe mjete pune funksionale.

Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë, pjesë e Planit të Veprimit 2019-2021, vijnë me masa konkrete në drejtim të zhvillimit strukturor, organizativ dhe thellim kapacitetesh njerëzore e profesionale për të bërë të mundur detyrimet që vijnë nga Strategjia.

Profesionet e lira ligjore janë bërë pjesë e Planit të Veprimit 2019-2021, me masa të parashikuara për t'u përmbushur dhe që vijnë si produkt i ndryshimeve ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi.



Plani i Veprimit 2019- 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, konsiston në:

- ✓ 8 objektiva strategjike;
- ✓ 11 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve;
- ✓ 7 indikatorë transhi të Bashkimit Evropian;
- ✓ 65 masa.

Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SND-së. Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 dhe mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar – 31 mars 2020.

Plani i Veprimit përbëhet nga 8 objektivat e mësipërme dhe përmban në total 65 masa. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të masave të SND bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë muajit prill 2020. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për periudhën janar – mars 2020, rezulton se niveli i zbatimit të masave të Planit të Veprimit është si më poshtë:

Statusi aktual i zbatimit të masave sipas Objektivave



Për periudhën janar – mars 2020 nga 65 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2019 – 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë realizuar 14 prej tyre, 41 prej tyre janë ende në proces zbatimi, 9 masa janë të porealizuara, si dhe 1 masë e paraportuar nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 është në nivelin 22% për masat të cilat janë të realizuara, 63% për masat në proces, 14% për masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse, si dhe 2% për masën e paraportuar nga institucioni (Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë).

a. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI REFORMËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

o Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë periudhës Janar – Mars 2020 ka vijuar intensivisht punën për përmirësimin e efikasitetit dhe të pavarësisë së gjykatave si dhe marrjen e masave për trajtimin e problematikave që kanë ardhur kryesisht si rrjedhojë e mungesës së gjyqtarëve dhe numrit të çështjeve të mbartura. Kjo periudhë karakterizohet edhe nga përhapja e Pandemisë COVID-19 që solli pasoja serioze edhe në funksionimin e sistemit gjyqësor, në përgjigje të së cilës KLGJ mori një sërë masash, renditur më poshtë në pikën 5 dhe që mund të aksesohen në <http://klgj.al/covid-19/>.

1. Gjykata e Lartë

KLJGJ, pas plotësimit të kuadrit nënligjor (Rregullat për kriteret dhe procedurën për promovimin e magistratëve në Gjykatën e Lartë - vendimi nr. 75, datë 23.05.2019; rregullat për kriteret dhe procedurën për emërimin e jo gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë - vendimi Nr.102 datë 5.07.2019), hapi procedurat e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur. Në përfundim të procedurave të kandidimit për secilin nga pozicionet e lira të shpallura, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për të gjithë konkurrentët, si dhe vlerësimin sipas meritave të kandidatëve të kualifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e tre kandidatëve, me vendimet nr. 110, 111 dhe 112 datë 27.2.2020, mbi bazën e të cilëve u emëruan si Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë respektivisht me dekretet nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020, të Presidentit të Republikës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor po vijon procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin për pozicionin e katërt nga radhët e juristëve të spikatur, si edhe vendosi në mbledhjen e datës 26.2.2020 hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për plotësimin e pozicioneve të tjera të lira në Gjykatën e Lartë.

Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” i hapi rrugë edhe promovimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë. Kështu, me vendimet nr. 82, 83 dhe 84 datë 26.02.2020, është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative, me vendimet nr. 85, 86 dhe 87, datë 26.02.2020, është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me *reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura* dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, Këshilli me vendimin Nr.317 datë 19.12.2019, ka miratuar ngritjen e një komisioni të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh. Përballë numrit të jashtëzakonshëm dhe kohës së gjatë të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar dhe në respektim edhe të kriterëve ligjore për gjykimin e tyre, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve vlerësoi se do të vijohet menjëherë me shqyrtimin e rekurseve të çështjeve të themelit, nisur nga kriteri i kohës së paraqitjes së tyre për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, krahas çështjeve të tjera që për nga natyra e tyre dhe sipas ligjit duhet të shqyrtohen në mënyrë të shpejtë, sikurse janë mosmarrëveshjet për juridiksionin, kompetencën,

kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve. Gjithashtu u formua edhe Kolegji Civil, Administrativ dhe Penal. Në Kolegjin Civil janë caktuar gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Ervin Pupe; në Kolegjin Administrativ gjyqtari Sokol Sadushaj dhe në atë Penal, gjyqtari Ilir Panda.

2. Gjykatat e Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Procesi i vënies në funksionim të **Gjykatave të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar** ka përfunduar dhe funksionimi i tyre është shpallur me vendim Nr.286 datë 18.12.2019. Këshilli, me vendimet nr. 287-304, datë 18.12.2019 ka caktuar në mënyrë të përhershme 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 13 gjyqtarë (në pritje të përfundimit të vlerësimit kalimtar të tyre).Ndërkohë që gjatë vitit 2020, KLGJ ka caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 1 gjyqtar. Ndërsa, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar janë caktuar në mënyrë të përhershme 4 gjyqtarë, si dhe në mënyrë të përkohshme 6 gjyqtarë. Gjatë këtij procesi janë transferuar edhe 9 gjyqtarë në gjykata të ndryshme (kryesisht për shkak të pezullimit të tyre sipas vendimit të shkarkimit të KPK-së).

Përsa i përket **plotësimit të vendeve të tjera vakante në këtë gjykatë**, KLGJ-ja në mbledhjen e datës 7 shkurt 2020, pas një konsultimi me trupat gjyqësore dhe me partnerët ndërkombëtarë, miratoi me Vendimin nr.70, kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të detajuara që do të zbatohen për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë, ndër të tjera, edhe për Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për rrjedhojë, më datë 26 shkurt 2020 KLGJ hapi thirrjen për mbushjen e vakancave në këto gjykata, afatet e cilave u pezullua më pas në datë 12 mars 2020 për shkak të pandemisë globale COVID-19. **Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020** “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Covid-19”, KLGJ vendosi rifillimin e procedurave administrative të pezulluara, ndër të tjera edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

3. Procesi i Rivlerësimit Kalimtar

KLJGJ, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për periudhën Janar – Mars 2020 kanë organizuar 39 shorte për përzgjedhjen e dosjeve për 39 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Janë depozituar pranë KPK-së dhe ONM-së 11 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 55 dosje gjyqësore për 11 subjekte rivlerësi si dhe janë në proces 7 raporte të tjera.

Gjithsej, duke marrë parasysh edhe punën e realizuar që nga momenti i krijimit të organeve të pavaruara të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, deri më 31 Mars 2020 janë dorëzuar pranë KPK dhe ONM 221 raporte vlerësi.

4. Vlerësimi etiko – profesional i gjyqtarëve

KLGG, sipas përcaktimeve kushtetuese (neni 147/a i Kushtetutës) dhe neneve 68-99 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë” i ndryshuar, ka detyrim kryerjen e vlerësimit periodik etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Në këtë kuadër janë hartuar edhe aktet nënligjore për realizimin e këtij procesi me synim (i) përmirësimin e vazhdueshëm të aspektit etik dhe profesional të gjyqtarëve; (ii) vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve; (iii) zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe (iv) identifikimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhduesh.

Krijimi i standardeve në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, realizuar në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë (Euralius dhe Këshilli i Evropës), është realizuar duke mbajtur në konsideratë 3 akte kryesore të miratuara nga KLGG dhe që i përkasin skemës së vlerësimit. (Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 264, datë 21.11.2019 “Për miratimin e “metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” dhe nr.120 datë 05.03.2020 “Për miratimin e “formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”).

Programi i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve për vitin 2020 është miratuar me vendimin Nr.276 datë 10.12.2019 dhe parashikon vlerësimin e 121 gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.

Duke marrë shkas nga vijimi i situatës së fatkeqësisë natyrore në vend e krijuar nga COVID-19, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori vendimin për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të çështjeve urgjente. Për rrjedhojë, kjo do të ndikojë edhe në procesin e vlerësimit të gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.

5. Masat kundër përhapjes së COVID-19

KLGG, në përgjigje të pandemisë COVID-19, mori një sërë masash me karakter rregullator:

- me vendimin Nr.127, datë 10.03.2020, ka vendosur pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë. Përjashtohen nga efektet e këtij pezullimi veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme, të vlerësuara si të tilla rast pas rasti nga gjyqtari,
- me vendimin nr.135 datë 16.04.2020 vendosi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurtë të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë
- me vendimin nr.138 datë 16.04.2020 vendosi të bëjë disa ndryshime në buxhetin e KLGG-së për vitin 2020 me qëllim që këto fonde t'i vihen në dispozicion Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për përballimin e epidemisë Covid-19.
- me vendimin nr. 143 datë 22.04.2020 vendosi rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, më datë 27 prill 2020, sipas kufizimeve të përcaktuara në Aktin Normativ nr.9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave

të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.04.2020.

Gjithashtu, Këshilli miratoi me vendimin nr.141 datë 22.04.2020 “Rregullore për marrjen e masave kufizuese për përhapjen e Covid – 19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin e Këshillit nr. 135, datë 16.04.2020, me qëllim hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash organizative dhe administrative, në situatën e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, me vendimin e tij nr. 142, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Covid-19” vendosi ndër të tjera edhe Rifillimin e procedurave administrative të pezulluara:

- a) për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë;
- b) për ngritjen në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar;
- c) për komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- ç) për komandimin në Shkollën e Magjistraturës;
- d) për komandimin në Ministrinë e Drejtësisë.

6. Karriera e gjyqtarëve

Këshilli, me vendimin Nr. 70, datë 07/02/2020 përcaktoi **rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën që ndiqet për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë** sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rregullat e këtij vendimi janë të zbatueshme për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë dhe që përmbushin kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në pozicionet e mëposhtme:

- a) gjyqtar në Gjykatën e Lartë, kur ka një ose më shumë pozicione të lira;
- b) gjyqtar në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, kur ka një ose më shumë pozicione të lira;
- c) gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, kur ka një ose më shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet lëvizjes paralele;
- ç) gjyqtar në një gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, kur ka një ose më shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen nëpërmjet lëvizjes paralele.

Një **proces i plotë verifikimi** (i ngjashëm me atë të vetting-ut) është kryer nga Komiteti i Zhvillimit të Karrierës në lidhje me kriteret e përvojës profesionale, aseteve dhe prejardhjes për 76 aplikantë për pozicione të ndryshme:

- 10 kandidatë magjistratë që mbaruan Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.
- 15 kandidatë magjistratë që përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.
- 28 kandidatë që u regjistruan në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.
- 23 kandidatë për gjyqtar në Gjykatën e Lartë

7. Të tjera

Këshilli, gjithashtu ka miratuar rregullat e nevojshme (vendimi nr. 22 dhe 23, datë 7.02.2019) për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magistratëve dhe periudhën e shërbimit sipas *skemës së lëvizshmërisë*; rregullat për njoftimet dhe metodat për mbushjen e *vendeve vakante të përkohshme* (të krijuara nga komandimet, transferimet, promovimet etj.); për organizimin dhe *transferimin* paralel për magistratët; rregullat për kriteret dhe procedurën për *promovimin* e magistratëve në nivele më të larta, etj.

Përsa i përket *procesit të emërimit dhe caktimit në detyrë të magistratëve* të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magistraturës në vitin 2018 dhe 2019, ky proces ka përfunduar dhe janë emëruar në detyrë 10 magistratë të diplomuar në vitin 2018 - vendimet nr. 145-154, datë 30/07/2019 dhe 15 magistratë të diplomuar në vitin 2019 (vendimet nr. 42 – 56 të KLGJ, datë 29.01.2020).

KLJ gjithashtu, me vendimin Nr. 31, datë 23.01.2020 ka përcaktuar numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës, për vitin akademik 2020-2021, ku numri i kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës, për vitin akademik 2020-2021, është 40 (dyzetë), ndërsa, numri i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës, për vitin akademik 2020-2021, është 25 (njëzetë e pesë).

Më datën 5 shkurt 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim të ngushtë me USAID, bëri aktive *faqen e re të internetit* (www.klgj.al). Faqja e re veçse përmbush detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, synon vendosjen e marrëdhënieve proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median.

Gjatë tre muajve të parë të vitit 2020, Këshilli ka trajtuar **163** kërkesa për caktim gjyqtari gjithësej, (nga të cilat: 39 kërkesa të ardhura nga gjykatat e rretheve gjyqësore; 1 kërkesë e ardhur nga gjykatat administrative; 119 të ardhura nga gjykatat e apeleve; si dhe 4 kërkesa të ardhura nga Gjykata e Lartë) në përgjigje të të cilave janë caktuar **240** gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme (nga të cilët **49** gjyqtarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore, **1** nga gjykatat administrative të shkallës së parë dhe **189** nga gjykatat e apeleve juridiksion i përgjithshëm dhe posaçëm).

Në proces, dhe në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLGJ “Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave”, po përgatitet projektakti për elementet kryesore procedurale dhe materiale të ecursisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore. Në funksion të vendosjes së standardeve që garantojnë një sistem gjyqësor sa më profesional dhe etik, KLGJ ka në proces hartimin e këtij projektakti, fokusi i të cilit është përcaktimi i organeve dhe procedurave disiplinore, si dhe përcaktimi në mënyrë të qartë i elementeve kryesore procedurale dhe materiale të ecursisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore.

KLP është një nga institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili u krijua në kuadër të reformës në drejtësi, pas ndryshimeve në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe miratimit të ligjeve të posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve që përbëjnë sistemin e drejtësisë.

Neni 149, i Kushtetutës parashikon se KLP është organ kolegjal i përbërë nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 anëtarë zgjidhen nga radhët e prokurorëve të të gjitha niveleve dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi midis radhëve të juristëve. Përkatësisht, më datë 11 dhjetor 2018, u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e gjashtë anëtarëve prokurorë të KLP, ndërsa takimi i parë i KLP u mbajt më datë 19 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.

KLP garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

○ *Mbi procedurën e krijimit të SPAK*

Gjatë periudhës raportuese ka marrë formë të prerë vendimi i konfirmimit në detyrë të Znj. Doloreza Musabelliu, pasi nuk ka patur ankimim nga Komisioneri Publik. Me vendimin nr. 29, datë 31.01.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi emërimin prokuror në SPAK të Znj. Doloreza Musabelliu, e cila më pas kreu betimin në Presidencë. Prej këtij momenti, kjo strukturë përbëhet nga nëntë anëtarë.

Sa i përket kandidatëve të tjerë për prokuror të SPAK, për Znj. Anita Jella, vendimi i konfirmimit në detyrë nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë vendimi më datë 10.12.2019 dhe është zbardhur më 10.02.2020. Më datë 25.02.2020, Komisioneri Publik ka ushtruar ankim ndaj vendimit të KPK. Pritet caktimi i datës së shqyrtimit të çështjes nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Ndërsa, për Z. Anton Martini, konfirmuar më 29.01.2020 nga KPK, është zbardhur vendimi më datë 24.03.2020. Pritet nëse Komisioneri Publik do ta ankimojë vendimin apo jo, brenda 15 ditëve nga momenti i njoftimit.

Gjithashtu, Prokurorja Manjola Kajana është konfirmuar nga KPK, por ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga Komisioneri Publik. Më datë 06.03.2020 është zhvilluar seanca gjyqësore publike, ku Komisioneri ka kërkuar çeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave përkatëse në funksion të ankimit. Komisioneri Publik kërkoi ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit nr. 162, datë 19.06.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. KPA vendosi që seanca e radhës të ishte më datë 26.03.2020, por për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19, ka njoftuar përmes faqes së ëeb-it, shtyrjen e kësaj seance. Për prokuroren Elisabeta Imeraj nuk ka asnjë datë të parashikuar.

Gjithashtu, KLP pasi shpalli me Vendimin nr. 19, datë 27.01.2020¹, njoftimin për plotësimin e dy vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme, e cila përmbushet përmes procedurës së ngritjes në detyrë, njoftoi gjithashtu edhe kriteret që duhen plotësuar për të qenë pjesë e garës. Kriteret që duhet të plotësonin kandidatët për prokuror u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KLP.

¹ Ndryshuar me Vendimin nr. 54, datë 24.02.2020, sa i përket afatit të shprehjes së interesit, nga 15 ditë në 40 ditë.

Kandidatët që shprehën interesin, paraqitën dokumentacionin përkatës dhe me Vendimin nr. 84, datë 18.03.2020, KLP miratoi listën e kandidatëve për prokurorë, të cilët plotësojnë kushtet ligjore, pas vlerësimit paraprak. Numri i kandidatëve që do të vijnë garën është 4 (katër).

○ *Aktet e miratuara nga KLP në periudhën Janar-Mars 2020*

Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë marrë këto vendime:

- 36 Vendime komandimi dhe caktimi të përkohshëm prokurorësh;
- 1 Vendim për Komandimin e një magjistrati pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 10 Vendime emërimi prokurorësh;
- 1 Vendim ndërprerje komandimi;
- 2 Opinione dhe projektvendime për qëllime komandimi;
- 2 Vendime dhe njoftim shpalje me qëllim plotësim vendesh për Komandim magjistrati pranë KLP dhe ILD.

Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale janë marrë këto vendime:

- 10 Vendime për miratimin e Relacionit mbi verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës;
- 3 Vendime për miratimin e Raportit për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatëve për t'u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.
- 10 Vendime për miratimin e Raporteve për analizimin e aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit (prokuror);
- 1 Vendim për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës për magjistratët, kandidatë për t'u komanduar si inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 1 Vendim për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë.

Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve, janë përgatitur dhe miratuar 5 vendime për mbrojtjen e veçantë për pesë raste kërkesë nga prokurorë.

Janë marrë gjithashtu dy vendime për mbarimin e mandatit të anëtarit të KLP, për Z. Besnik Cani (Vendim i KLP nr. 76, datë 04.03.2020, pas njohjes me Vendimin nr. 2, datë 27.02.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkarkimin e tij dhe relacionit të përgatitur nga Komisioni i Disiplinës) dhe për Z. Arben Dollapaj (Vendim i KLP nr. 90, datë 25.03.2020, pas njohjes me Vendimin nr. 4, datë 12.03.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkarkimin e tij dhe relacionit të përgatitur nga Komisioni i Disiplinës).

○ *Akte nënligjore*

Janë në proces:

- Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë”;
 - Rregullorja “Mbi rregullat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve”.
- *Aktivitete të tjera*

Më datë 17.02.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi ceremoninë e betimit të prokurorëve të rinj, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2018-2019.

Ceremonia u mbajt në prani të anëtarëve të Këshillit, Ambasadorit të Delegacionit të Bashkimit Europian Z. Luigi Soreca, përfaqësuesve nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, EURALIUS, OPDAT, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Z. Arben Kraja, si dhe disa prej drejtuesve të prokurorive në rretheve.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), në zbatim të nenit 149/d të Kushtetutës, kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, midis radhëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ata ushtrojnë mandatin e tyre për një vit.

Në datë **15.01.2020** u zhvillua mbledhja e parë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020 dhe mori në shqyrtim çështjes si më poshtë, me këtë rend dite:

1. *Konstituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përbërjen e zgjedhur për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për vitin kalendarik 2020.*
2. *Çështje të mbështetjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me mjete buxhetore, personel administrativ, ambiente dhe pajisje pune nga Gjykata e Lartë për vitin 2020.*
3. *Informacion për vendet vakante ekzistuese për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të cilat sipas Kushtetutës plotësohen nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë.*
4. *Procedura e shortit për caktimin e anëtarëve relatorë për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendet vakante si më poshtë:*
 - Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z.Fatos Lulo.
U caktuar me short Relatore: Znj. Saida Dollani.
 - Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z. Besnik Imeraj.
U caktua me short Relatore: Znj. Arta Marku.
 - Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z. Besnik Muçi.
U caktua me short Relatore: Znj. Miranda Andoni.

Gjithashtu, pas organizimit të shortit për caktimin e këshilltarëve të ngarkuar me mbështetjen e veprimeve të relatorëve për dy nga vendet vakante, rezultatet janë si më poshtë:

1. Këshilltar: Z. Besmir Rrapaj
 - për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Altin Binaj, Artan Spahiu dhe Gentian Mete, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z. Besnik Muçi.
2. Këshilltar: Z. Florjan Kalaja
 - për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Znj. Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Z. Eugen Papandile, Znj. Sonila Bejtja dhe Znj. Zhaklina Peto, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z. Besnik Muçi.
3. Këshilltare: Znj. Laureta Nezaj
 - për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Znj. Arta Marku për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës së kandidatit Z. Besnik Muçi, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z. Besnik Imeraj.
 - për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Znj. Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Z. Dedë Kasneci dhe Z. Sergio Mazreku, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z. Besnik Muçi.
4. Këshilltar: Z. Saimir Nazifi
 - për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Znj. Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Z. Sinan Tafaj dhe Z. Shaqir Hasanaj, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Z. Besnik Muçi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi zhvilloi më datë **03.02.2020**, mbledhjen e tij të radhës, me këtë rend dite dhe vijuan me diskutimin e pikave përkatëse:

1. *Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;*
2. *Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”;*

3. *Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;*
4. *Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;*
5. *Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi zhvilloi më datë **05.02.2020**, mbledhjen e tij të radhës, vijoi me diskutimin e pikave përkatëse të datës 03.02.2020 dhe në përfundim të miratoi:

1. *Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;*
2. *Projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”.*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi zhvilloi më datë **06.02.2020**, mbledhjen e tij të radhës, vijoi me diskutimin e pikave përkatëse të datës 03.02.2020 dhe në përfundim të miratoi:

1. *Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;*
2. *Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.*
3. *Gjithashtu, Këshilli ngarkoi Kryetarin që, brenda një afati një muajor, me mbështetjen e këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, të përgatisin dokumentin e projektregullores së brendshme me objekt detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, kryerjen e veprimeve të ndryshme administrative, krijimin,*

qarkullimin, ruajtjen dhe mbajtjen e dokumentacionit dhe të regjistrave, të protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve.

Për shkak të situatës së krijuar në vend, nuk ka zhvillime te tjera.

Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

Në mbështetje të nenit 147/d e vijues, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kreut IV, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjen e Zotit Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë” **nga data 1.02.2020, është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D).**

Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë menjëherë masat e nevojshme për organizimin dhe funksionin e këtij institucioni të ri. Ky proces po shoqërohet nga ana e ILD me identifikimin e kostove financiare, sigurimin e fondeve buxhetore, hartimin e strukturave organizative të personelit, rekrutimin e stafit, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tij.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjatë periudhës kohore 01.02.2020 - 30.03.2020 edhe pse në mungesë të burimeve njerëzore, ka ndër marrë veprime administrative lidhur me shqyrtimin, verifikimin, si dhe hetimin e pretendimeve të paraqitura nga ana e personave fizik ose juridik lidhur me veprimet apo mosveprimet e magjistratëve, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

Konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në proces administrimi dhe shqyrtimi fillestar të një volumi të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, të cilat janë dorëzuar gjatë periudhës transitore 2017-2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose Prokurorisë së Përgjithshme. ILD gjithashtu nga data 01.02.2020, datë në të cilën konsiderohet fillimi i veprimtarisë së tij, po administron të gjitha ankesat e paraqitura pranë tij nga ana e personave fizik, ose juridik.

Ecuria e këtyre proceseve është ngadalësuar për shkak se institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është hasur me mungesën e burimeve njerëzore për shkak të pezullimit të procedurave të rekrutimit të punonjësve nga ana e Departamentit të Administratës Publike si pasojë e pandemisë botërore COVID-19, si dhe mungesës së inspektorëve. Aktualisht nga ana e Këshillave janë komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm dy magjistratë. Në të njëjtën kohë, pezullimi i veprimtarisë së gjykatave, ka ndikuar në krijimin e vonesave për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e tyre.

Për këtë qëllim, janë kryer të gjitha veprimet e para për regjistrimin e institucionit të ri pranë organeve tatimore, sigurimin e mjeteve identifikuese, regjistrimin dhe publikimin e domainit (ild.al), hostimit të faqes zyrtare të institucionit (www.ild.al), si dhe pajisjen me llogari të postës elektronike zyrtare.

Me qëllim fillimin sa më parë të veprimtarisë së institucionit në mbështetje të nenit 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me

Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka miratuar një strukturë organizative dhe organike të përkohshme me 40 punonjës, për të cilët janë shpallur dhe po zhvillohen procedurat e rekrutimit të tyre.

Në të njëjtën kohë, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë me organike të plotë në mbështetje të nenit 197, pika 4, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është dërguar për shqyrtim dhe miratim pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë struktura dhe numri i punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në kuadër të procedurave të rekrutimit të stafit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në mbështetje të nenit 283, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 536, datë 25.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve me qëllim plotësimin e pozicioneve vakante inspektor (jomagjistratë) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 211, pika 2, të nenit 204, pika 1, shkronja “c” dhe “k”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me Urdhrin Nr. 7, datë 04.03.020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është miratuar Rregullorja “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Në mbështetje të nenit 283, pika 10, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 168, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë të evidentohen inspektorët, të cilët do të konsiderohen si të komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkak se kanë statusin e magjistratit dhe janë caktuar për kryerjen e hetimeve disiplinore.

Në të njëjtën kohë, në mbështetje të nenit 53, pika 2, nenit 54 dhe 55, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur kërkesë për nisjen e procedurave për komandimin në pozicionin e inspektorit për një periudhë pesë vjeçare pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të 6 (gjashtë) magjistratëve gjyqtarë; 5(pesë) magjistratëve prokurorë; si dhe 1 (një) magjistrat prokuror si ndihmës magjistrat pranë kësaj zyre.

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 69, datë 07.02.2020, ka komanduar përkohësisht si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistraten znj. Marsela Pepi, **si dhe në mbledhjen e datës 26.02.2020, ka vendosur të hap procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione inspektor, në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin Nr. 37, datë 05.02.2020, ka shpallur fillimin e procedurës për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes procedurës së komandimit, si dhe me vendimin Nr. 77, datë 04.03.2020, ka komanduar Znj. Mirela Kapo, prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Krujë, në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nisur nga përcaktimet ligjore se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore, bazuar në nenin 119 e vijues, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, dhe Ministrisë së Drejtësisë, të dërgohen pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

- Ankesat e depozituara nga çdo person fizik, ose juridik lidhur me pretendimin për shkeljet e kryera nga ana e magjistratëve;
(Gjatë periudhës 23.01.2020- 30.03.2020 rezultojnë të jenë paraqitur 229 ankesa në total, dhe në bazë të tyre i është kthyer shkresë konfirmimi (229 të tilla), çdo ankuesi mbi marrjen e ankesës dhe shqyrtimin e saj nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.)
- Dosjet disiplinore në proces hetimi;
- Problematikat e konstatuara që kanë të bëjë me përmbushjen e detyrave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Çështjet e lidhura me inspektimet tematike dhe institucionale sipas kërkesave të nenit 194, pika 4, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar.

Sa i përket vendimeve të miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, lidhur me ankesat e paraqitura pranë ILD-së, rezulton të jenë miratuar:

- 2 vendime verifikimi pas shqyrtimit fillestar të ankesave;
 - 7 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar të ankesave.
- o Procesi i vlerësimit dhe ecuria e institucioneve ri-vlerësuese

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është organ i ri kushtetues, me mandat 5-vjeçar, i krijuar me ndryshimet e reja të Kushtetutës, si pjesë e paketës për Reformën në Drejtësi, për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 82/2017, datë 17.6.2017, miratoi në bllok listën me 12 komisionerë. Veprimtaria e Komisionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i ligjit është rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve (subjekteve të rivlerësimit) në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni vlerëson çështjet e subjekteve të rivlerësimit në 4 trupa gjykuese me 3 anëtarë secila, bazuar në tre kritere:

- a) Vlerësimi i pasurisë;
- b) Vlerësimi i figurës;
- c) Vlerësimi i aftësive profesionale.

Gjatë periudhës *janar – mars 2020*, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **25 vendime**, nga të cilat:

- ✓ 7 vendime konfirmimi në detyrë për 5 gjyqtarë dhe 2 prokuror;
- ✓ 7 vendime shkarkimi nga detyra për 6 gjyqtarë dhe 1 prokuror;
- ✓ 11 vendime ndërprerje të procesit për 7 gjyqtarë, 2 prokurorë, 1 ndihmës ligjor dhe 1 inspektor ILD-je (Ndue Gjura).

Gjatë periudhës janar-mars 2020, janë zhvilluar gjithsej **24** seanca dëgjimore.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Kolegji i Posaçëm i Apelimit vijon të ushtrorë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelimit është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në total për periudhën *janar – mars 2020*, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka shpallur **5 vendime**. Nga 5 çështjet të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur:

- ✓ Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – **në 2 vendime**;
- ✓ Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - **në 3 vendime**.

Lidhur me pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e fakteve, të parashikuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016; ky organ raporton se **për periudhën 01.01.2020 – 31.03.2020 janë regjistruar dhe trajtuar 63 denoncime**.

Institucioni i Komisionerëve Publikë

Institucioni i **Komisionerëve Publikë** si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca:

- a. Ankimon në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 15 ditë pas njoftimit (neni 63 i ligjit nr. 84/2016).
- b. Përgatit raportin me shkrim me arsyet e refuzimit për moszbatimin e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (aneksi kushtetues, neni B “Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit).
- c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

Institucioni i **Komisionerëve Publikë**, për periudhën *janar – mars 2020*, është njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për **26 vendime dhe 4 vendime të njoftuara nga KPK në fund të dhjetorit 2019, pra vendime të shqyrtuara nga IKP janë në total 30**. 3 prej tyre janë ankimuar dhe për 27 vendime është vendosur mosankim.

Në regjistrin e denoncimeve të publikut, për periudhën *janar - mars 2020*, janë regjistruar **72 denoncime**.

Aktet nënligjore dhe normative të miratuara nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë

- Rregullorja “Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë”.
- Rregullore e brendshme administrative e Institucionit të Komisionerëve Publikë.
- Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerëve Publikë, ndryshuar me vendimin e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë nr. 7, datë 16.12.2019.
- Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Institucionin e Komisionerëve Publikë”, ndryshuar me vendimin e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë nr. 2, datë 15.2.2019.
- Rregullore për median.

Ministria e Drejtësisë ka lehtësuar procesin e rivlerësimit në tre drejtime kryesore:

- Duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për organet e rivlerësimit;
- Duke siguruar mjetet financiare për organet e rivlerësimit;
- Duke bashkëpunuar me organet e vetingut mbi kërkesat për informacion të paraqitura në kuadër të procesit të rivlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit që po kryhen nga këto organe.

Përsa më sipër, për periudhën *janar 2020 – mars 2020*, në Ministrinë e Drejtësisë janë administruar **84** shkresa të ardhura nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ku kanë kërkuar informacion nga Regjistri Elektronik i Noterëve (RNSH) për veprimet noteriale të kryera pranë zyrave noteriale të Republikës së Shqipërisë, nga subjektet e rivlerësimit.

Pas kërkimeve në RNSH, për secilën kërkesë, Ministria e Drejtësisë ka vënë në dispozicion listën e noterëve ku subjekti ka kryer veprime noteriale, në bazë të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, në Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën nga *1 janar 2020 deri në 31 mars 2020* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit

të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit të SND-së. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivit dhe aktivitetit, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimit të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të masave, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektiv. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht online, për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura.

Pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft-raportin e monitorimit para se të miratohet nga Mekanizmi Institucional i Monitorimit/Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi.

Në zbatim të VKM nr. 773, datë 2.11.2016, mbi miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka menaxhuar mekanizmin institucional për monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Mekanizmi institucional për monitorimin e kësaj strategjie realizohet nëpërmjet një strukture të veçantë, në përbërjen e të cilit janë:

- Zëvendësministri i Drejtësisë;
- 5 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- 1 përfaqësues nga Këshilli i Ministrave që mbulon çështjet e koordinimit të dokumenteve strategjike;
- 1 përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- 1 përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- 1 përfaqësues nga Inspektorati i Lartë;
- 1 përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese;
- 1 përfaqësues nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm;
- 1 përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës;
- 1 përfaqësues nga Avokati i Popullit;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterëve;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat;
- 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

Përsa më sipër të gjitha institucionet kanë përcaktuar përfaqësuesit e tyre në mekanizmin e monitorimit. Ky mekanizëm vlerëson dhe miraton Raportet periodike të Monitorimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Për më tepër, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e

Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, janë krijuar 5 Komitete Drejtuese Sektoriale (KDS). Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është parashikuar ngritja e Komitetit Drejtues Sektorial (KDS) për Reformën në Drejtësi.

Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi, drejtohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka anëtarë:

- Ministrin e Drejtësisë;
- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
- Kabinetin e Kryeministrit (ZOS, Këshilltarë);
- Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri;
- Departamentin e Burimeve, Transparencës dhe Miradministrimit, në Kryeministri.

Të ftuar: Përfaqësues nga Kuvendi, KLP, KLGJ, KED, PP, SHM, ILDKPKI, Avokati Popullit, Dhomat Kombëtare (të Avokatisë, Noterëve, Ndërmjetësve, Përmbauesve), Donatori/Pika fokale për fushën etj., si dhe të tjerë, sipas vendimmarrjes nga drejtuesi i KDS-së.

KDS do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikën me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

Në kontekstin e integritimit evropian, këto struktura do të luajnë rolin e Komitetit Sektorial Monitorues për projektet IPA, duke siguruar raportimin e monitorimit të fondeve IPA, sipas sektorëve.


III. DISBURSIMI FINANCIAR

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitet 2017 - 2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë ishte vlerësuar në 98,385,653 Euro. Në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e Planit të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën 2019 - 2021. Në vijim, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 409, datë 19.06.2019 miratoi Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Përsa i përket kostove të parashikuara në Planin e Veprimit për vitet 2019 – 2021, rezulton se:

- 3.165.677 (në mijë lekë) mbulohen nga buxheti i shtetit;

- 5.830.122 (në mijë lekë) mbulohen nga donatorët².



IV. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së secilit objektiv të Strategjisë dhe pasqyron grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për periudhën janar – mars 2020³.



Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 1

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 1	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 1
Të realizuara	3	23%
Në proces	10	77%
Të porealizuara	0	0%
Totali	13	100%

² Buxhetimi i masave të profesioneve të lira ligjore do të mbulohet nga të ardhurat e vetë Dhomave, si ente private me vetëfinancim.

³ Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është pasqyruar në aneksin 2 të Raportit të Monitorimit.




Rezultoni se nga 13 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 1, janë realizuar 3 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 10 prej tyre. Për qindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektivi, është në nivelin 23% për masat të cilat janë të realizuara dhe 77% për masat në proces zbatimi.

Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 2

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 2	Numri i masave	Për qindja ndaj totalit të Objektivit 2
Të realizuara	0	0%
Në proces	4	100%
Të porealizuara	0	0%
Totali	4	100%




Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 2, të katër janë në proces zbatimi.

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 100% për masat në proces.

Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 3

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 3	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 3
Të realizuara	1	20%
Në proces	4	80%
Të porealizuara	0	0%
Totali	5	100%





Rezulton se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 3, është realizuar 1 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 4 prej tyre. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv është në nivelin 20% për masën e realizuar, dhe 80 % për masat në proces.

Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 4

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 4	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 4
Të realizuara	1	25%
Në proces	2	50%
Të porealizuara	1	25%
Totali	4	100%





Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 4, është realizuar 1 prej tyre, janë ende në proces zbatimi 2 prej tyre, si dhe rezulton si masë e porealizuar nga institucioni përgjegjës 1 prej tyre. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 25 % për masën e cila është e realizuar, 50% për masat në proces dhe 25 % për masën e cila do të zbatohet në vijim nga institucioni përgjegjës.

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 5

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 5	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 5
Të realizuara	1	10%
Në proces	5	45%
Të porealizuara	5	45%
Totali	11	100%





Rezulton se nga 11 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 5, është realizuar 1 prej tyre, janë në proces zbatimi 5 masa dhe rezultojnë si masa të parrealizuara nga institucionet përgjegjëse 5 prej tyre. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 10% për masat të cilat janë të realizuara, 45% për masat në proces dhe 45% për masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 6

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 6	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 6
Të realizuara	3	60%
Në proces	2	40%
Të parrealizuara	0	0%
Totali	5	100%





Rezulton se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 6, janë realizuar 3 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 2 prej tyre. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv është në nivelin 60 % për masat të cilat janë të realizuara dhe 40 % për masat në proces.

Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 7

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 7	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 7
Të realizuara	2	18%
Në proces	6	55%
Të porealizuara	3	27%
Totali	11	100%





Rezulton se nga 11 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 7, janë realizuar 2 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 6 prej tyre, si dhe rezultojnë si masa të paraportuara 3 prej tyre. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 18 % për masat të cilat janë të realizuara, 55 % për masat në proces dhe 27% për masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 8

Janar – Mars 2020		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 8	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 2
Të realizuara	3	25%
Në proces	8	67%
Të porealizuara	0	0%

Të paraportuara	1	8%
Totali	12	100%



Rezultoni se nga 12 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 8, janë realizuar 3 prej tyre, 8 prej tyre janë ende në proces zbatimi, si dhe 1 masë është e paraportuar nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv është në nivelin 25% për masat të cilat janë të realizuara, 67% për masat në proces, si dhe 8% për masën e paraportuar nga institucioni përgjegjës.

V. ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS 2020.

Arritjet kryesore më të rëndësishme, në zbatim të Planit të Veprimit 2019 – 2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë si më poshtë vijon:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor, në datën 5 shkurt 2020, në bashkëpunim të ngushtë me USAID, bëri aktive *faqen e re të internetit* (www.klgj.al). Faqja e re veçse përmbush detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, synon vendosjen e marrëdhënieve proaktive,

transparente e informuese me publikun dhe median.

- Këshilli ka miratuar dhe vënë në funksionim një numër aktesh rregullatore që synojnë përmirësimin e eficiencës dhe të pavarësisë së gjykatave si: skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave etj. Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2020, Këshilli ka trajtuar **163** kërkesa për caktim gjyqtari. Në përgjigje të këtyre kërkesave janë caktuar **240** gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme.
- Ka përfunduar procesi i vënies në funksionim të Gjykatave të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe funksionimi i tyre është shpallur me vendim Nr. 286 datë 18.12.2019. KLGJ ka caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 1 gjyqtar. Ndërsa, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar ka caktuar në mënyrë të përhershme 4 gjyqtarë, si dhe në mënyrë të përkohshme 6 gjyqtarë.
- Pas përfundimit të procedurave të kandidimit për secilin nga pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e lartë, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për të gjithë konkurrentët, si dhe vlerësimin sipas meritave të kandidatëve të kualifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 110, 111 dhe 112 datë 27.2.2020, vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e tre kandidatëve. Me dekretet nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020, të Presidentit të Republikës, u emëruan në Gjykatën e Lartë, gjyqtarët S.Sadushaj, E.Pupe dhe I.Panda.
- KLGJ, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për periudhën Janar – Mars 2020 kanë organizuar 39 shorte për përzgjedhjen e dosjeve për 39 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Janë depozituar pranë KPK-së dhe ONM-së 11 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 55 dosje gjyqësore për 11 subjekte rivlerësimi si dhe janë në proces 7 raporte të tjera. Gjithsej, duke marrë parasysh edhe punën e realizuar që nga momenti i krijimit të organeve të pavaruara të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve deri më 31 Mars 2020 janë dorëzuar pranë KPK dhe ONM 221 raporte vlerësimi.
- KLP pasi shpalli me Vendimin nr. 19, datë 27.01.2020⁴, njoftimin për plotësimin e dy vëndeve vakante në Prokurorinë e Posaçme, kriteret që duhet të plotësonin kandidatët për prokuror u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KLP.
- Kandidatët që shprehën interesin, paraqitën dokumentacionin përkatës dhe me Vendimin nr. 84, datë 18.03.2020, KLP miratoi listën e kandidatëve për prokurorë, të cilët plotësojnë kushtet ligjore, pas vlerësimit paraprak. Numri i kandidatëve që do të vijojë garën është 4 (katër).

⁴ Ndryshuar me Vendimin nr. 54, datë 24.02.2020, sa i përket afatit të shprehjes së interesit, nga 15 ditë në 40 ditë.

- Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, KLP ka vijuar me miratimin e një sërë vendimesh.
- Në mbështetje të nenit 147/d e vijues, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kreut IV, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjen e Zotit Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë” nga data 1.02.2020, është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D), duke shënuar kështu një hap shumë të rëndësishëm në zbatimin e reformës në drejtësi.
- Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë menjëherë masat e nevojshme për organizimin dhe funksionin e këtij institucioni të ri. Ky proces po shoqërohet nga ana e ILD me identifikimin e kostove financiare, sigurimin e fondeve buxhetore, hartimin e strukturave organizative të personelit, rekrutimin e stafit, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tij.
- **Shkolla e Magjistraturës** në bashkëpunim me Qendrën Hollandeze të Studimeve dhe Trajnimit Gjuqësor (SSR) dhe Misionin Euralius V, pas miratimit të kurrikulës mësimore të vitit të parë të Programit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarë ndihmës ligjorë, ka filluar procesin e përmirësimit të kurrikulës mësimore të vitit të dytë të Progrsmit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë.
- Në bashkëpunim me UNDP, OSFA dhe Ministrinë e Drejtësisë janë ngritur dhe funksionojnë 3 Qendra të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, përkatësisht në qytetet e Elbasanit, Durrësit dhe Fierit,
- Ministria e Drejtësisë ka realizuar disa aktivitete me karakter ndërjegjësues, në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike falas. Është realizuar në qytetin e Elbasanit, fushata e ndërjegjësimit me qëllim njohjen për zbatimin në praktikë të Ligjit 111/2017, për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, me aktorët kryesorë subjekte të këtij ligji, si dhe pjesëmarrës nga shoqëria civile. Gjithashtu është realizuar dhe sesioni informues/ seminar i zhvilluar pranë Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve, Kavajë, me qëllim ndërjegjësimit dhe edukim të një prej kategorive të veçanta të ligjit të ri të ndihmës juridike.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** në funksion të rehabilitimit dhe ri-integrimit të të burgosurve që konsiderohet edhe si thelbi i misionit të sistemit të burgjeve ka ndërmarrë masa të vazhdueshme për të bërë të mundur zbatimin e një regjimi kuptimplotë aktivitetesh për këtë kategori.
 - Për periudhën raportuese janë punësuar mesatarisht në sistemin e burgjeve 574 të burgosur prej të cilëve 138 të paraburgosur.
 - Kurset profesionale janë ofruar në 9 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 287 të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektrikist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldatim.
 - Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën aktivitete të tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve është 2756.

- Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 192 tema sociale në muaj dhe 37 recensione librash, si dhe janë zhvilluar 365 aktivitete ri-integruese.
 - Është nëzbatim një dokument politikash për trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve sipas nevojave të tyre, si dhe programe edukuese për të burgosurit në prag lirimi. Qëllimi i këtyre programeve është ri-integrimi i suksesshëm në shoqëri i të burgosurve dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste. Këto kurse janë ndjekur nga 22 të burgosur.
- Si rezultat i zbatimit të **Ligjit Nr.5/2020 “Për Dhënie Amnistie”**, krahasuar me vitin 2019, niveli i popullimit të burgjeve është ulur me 5%. Për zbatimin e këtij ligji janë marrë masat e duhura dhe të nevojshme për efektivitetin e aplikimit të tij në mënyrë sa më rigorozë, në të gjitha IEVP-të.
 - Gjatë muajit janar 2020, **Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë**, pranë Kryeministrisë me qëllim rritjen e kapaciteteve brenda ministrive të linjës, ka koordinuar me ministrinë për zgjerimin e Rrjetit të Përhershëm të RIA-s, duke shtuar numrin e anëtarëve nga cdo ministri, ku padyshim përfshihet dhe Ministria e Drejtësisë. Në muajin shkurt 2020 janë organizuar me mbështetjen e ekspertëve të asistencës teknike të BE-së, 4 (katër) seksione trajnimesh për këtë proces, me pjesëmarrjen e pothuaj të gjithë anëtarëve të Rrjetit të RIAs. Ky proces do të vijoj.

VI.KONKLUZIONE

Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikën më të mira evropiane mbetet misioni i kësaj strategjie.

Gjatë kryerjes së procesit të monitorimit janë evidentuar disa problematika që vlerësohen se kanë ndikuar në nivelin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Ndër elementët më të rëndësishëm të cilët kanë ndikuar në realizimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit janë si më poshtë:

- ✚ Vijon të mbetet problematike përgjegjshmëria e institucioneve për të raportuar në kohë dhe me cilësi lidhur me informacionin mbi masat e Planit të Veprimit. Nevojitet një bashkëpunim më i lartë i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë, për të kontribuar dhe raportuar lidhur me implementimin e Planit të Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.
- ✚ Mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit, ndikon në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë.
 - Institucionet kanë raportuar se hasin vështirësi në raportim lidhur me:

- buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga donatorët (informacion i cili nuk disponohet nga të gjitha pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese);
- buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga buxheti i shtetit

VII. SFIDAT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2019 - 2021, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- ✚ Gjithëpërfshirja e aktorëve të sistemit të drejtësisë dhe grupeve të interesit gjatë fazave të raportimit, konsultimit dhe monitorimit.
- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse, nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstytucional.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.

Plani i Veprimit 2019 - 2021
Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë

(Për periudhën janar -mars 2020)

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë								
Nën-objektivi 1/a: Pavarësia e institucioneve të sistemit të drejtësisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 – 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar/në proces/ e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Hartimi i bazës nënllogore për përcaktimin e kriterëve dhe standardeve të meritokracisë dhe transparencës në emërimet dhe promovimet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe administratës gjyqësore.	KLJGJ, KLP	Zbatimi i standardeve		7 400			Në proces	<p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë: Raporton se gjatë periudhës janar 2020-mars 2020 janë në proces diskutimi draftet e përgatitura për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë”; - Rregulloren “Mbi rregullat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve”. <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor: Këshilli i Lartë Gjyqësor, për periudhën raportuese janar 2020-mars 2020, me vendimin nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” ka përcaktuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën që zbaton KLJGj për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rregullat e këtij vendimi janë të zbatueshme për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë dhe që përmbushin kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Gjykatën e Lartë; b) Gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) Gjykatën Administrative të Apelit

							ç) Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Një tjetër element i rëndësishëm është edhe plotësimi i kuadrit nënligjor për krijimin e skemes së vlerësimit etiko-profesionale të gjyqtarëve. Në këtë kuadër mund të përmendet Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, nr. 264, datë 21.11.2019 dhe nr.120 datë 05.03.2020. Programi i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve për vitin 2020 është miratuar nga KLGJ dhe parashikon vlerësimin e 121 gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.
2. Hartimi dhe vënia në funksionim e një platforme/metodologjie/praktike (pyetësor, sondazhi online etj) për monitorimin periodik të perceptimit të magistratëve mbi pavarësinë e brendshme të gjyqësorit.	KLJGJ, KLP			700			Në proces KLJGJ: KLJGJ në bashkëpunim me Bankën Botërore, ka planifikuar organizimin e një sondazhi që do të shtrihet në të gjithë sistemin gjyqësor, dhe që do të ketë në fokus evidentimin e efencës, pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit. Duke marrë shkas nga vijimi i situatës së fatkeqësisë natyrore në vend e krijuar nga virusi COVID-19, zhvillimi i sondazhit është shtyrë për një moment të dytë. KLP: Për periudhën Janar 2020-Mars 2020 nuk ka zhvillime.
3.Rritja e transparencës së vendimmarrjes në procesin e emërimeve / promovimeve të gjyqtarëve.	KLJGJ			10 000			Të gjitha vendimet e KLJGJ, sipas ligjit 115/2016, publikohen në faqen zyrtare të KLJGJ dhe sipas rastit në fletoren zyrtare. Kriteret dhe metodologjia e vlerësimit janë vendime normative dhe po kështu metodologjia e vlerësimit. Lista e kandidatëve shpallet në rubrikën njoftime ndërsa vendimmarrja, në respekt të të dhënave personale, gjendet e reflektuar në procesverbalet e mbledhjeve.

<p>4. Mbështetja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.</p>	<p>KLD/KLGJ/ KLP</p>	<p>1/4 e subjekteve (Mbledhja e statistikave, kryerja e shortit, mbledhja e informacionit të nevojshëm, analiza e informacionit, hartimi i relacionit dhe inventarizimi i praktikës.)</p>	<p>232 000</p>				<p>Realizuar</p>	<p>KLJGJ:KLJGJ, raporton se në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për periudhën Janar 2020 – Mars 2020 kanë organizuar 39 shorte për përzgjedhjen e dosjeve për 39 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Janë depozituar pranë KPK-së dhe ONM-së 11 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 55 dosje gjyqësore për 11 subjekte rivlerësimi, si dhe janë në proces 7 raporte të tjera.</p> <p>Gjithësej, duke marrë parasysh edhe punën e realizuar që nga momenti i krijimit të organeve të pavarura të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve deri më 31 Mars 2020 janë dorëzuar pranë KPK dhe ONM 221 raporte vlerësimi.</p> <p>KLP:Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në KLP, në mbështetje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për periudhën e raportimit, janë kryer 10 Raporte për analizimin e aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit (prokuror).</p>
<p>5. Ngritja dhe vënia në funksion e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me qëllim të rishikimit të CV-ve të anëtarëve të institucioneve të drejtësisë.</p>	<p>KED</p>		<p>13 000</p>				<p>Realizuar</p>	<p>Ministria e Drejtësisë:Në kuadër të vënies në funksionin të KED, është propozuar nga Ministri i Drejtësisë dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave, vendimi nr. 298, datë 10.05.2019, “Për një shtesë fondi, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë, miratuar për vitin 2019”.</p> <p>Këshilli i Emërimeve në Drejtësi:Për periudhën raportuese, ka zhvilluar 4 mbledhje, përkatësisht në datat 15.01.2020; 3.02.2020; 5.02.2020 dhe 6.02.2020.</p> <p>Në mbledhjen e parë të zhvilluar në datë 15.01.2020 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, raporton se mori në shqyrtim çështjet si mëposhtë:</p> <p>1.Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përbërjen e zgjedhur për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për vitin kalendarik 2020.</p> <p>2. Çështje të mbështetjes së KED me mjete buxhetore, personel administrativ, ambiente dhe</p>

								<p>pajisje pune nga Gjykata e Lartë, për vitin 2020.</p> <p>3. Informacionin për vendet vakante ekzistuese për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të cilat sipas Kushtetutës plotësohen nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë.</p> <p>4. Zhvilloi Procedurën e shortit për caktimin e anëtarëve relatorë për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për disa vende vakante.</p> <p>Në mbledhjen e datës 03.02.2020, raportohet se është vijuar me:</p> <p>1. Shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;</p> <p>2. Shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”;</p> <p>3. Shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;</p> <p>4. Shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;</p> <p>5. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019, në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.</p> <p>Në mbledhjen e datës 05.02.2020, raportohet se janë miratuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”; 2. Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”; <p>Ndërsa në mbledhjen e datës 06.02.2020, raportohet se janë miratuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”; 2. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. 3. Gjithashtu, Këshilli ngarkoi Kryetarin që, brenda një afati një mujor, me mbështetjen e këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, të përgatisin dokumentin e projektregullores së brendshme me objekt detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së
--	--	--	--	--	--	--	--	---

									Këshillit, kryerjen e veprimeve të ndryshme administrative, krijimin, qarkullimin, ruajtjen dhe mbajtjen e dokumentacionit dhe të regjistrave, të protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve.
Nën-objektivi 1/b: Përmirësimi i efikasitetit të drejtësisë									
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 – 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e përcaktuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020	
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë			
1.Funksionimi i plotë i KLGJ-së e KLP-së me kuadrin rregullator, kapacitetet dhe infrastrukturën e nevojshme për të përbushur funksionin.	KLJG KLP	Zbatimi në masën 70% i përmirësimeve të nevojshme në infrastrukturë. Monitorim dhe zbatim i planit të veprimit për normën e likuidimit dhe kohëzgjatjen e çështjeve në 4 gjykata.	30 000	1 470 000	21 568 (në mijë lekë)		Në proces	<p>KLP: Për periudhën janar 2020-mars 2020 raportohet se përmirësimi i infrastrukturës së KLP kushtëzohet nga finalizimi i implementimit të projektit të “Polit të drejtësisë”.</p> <p>Organigrama e miratuar nga Këshilli i Ministrave ka një numër prej 65 punonjësish.</p> <p>Për periudhën Janar 2020-Mars 2020 ka përfunduar procedura e rekrutimit të 4 nëpunësve civilë, si dhe është kryer 1 rekrutim jashtë shërbimit civil.</p> <p>Gjatë vitit 2019, në Njësinë e Mbështetjes së Komisioneve, në Departamentin e Shërbimeve Ligjore janë komanduar 6 Prokurorë, në pozicionin e këshilltarit, pranë kësaj njësie. Duke qenë se, periudha një vjeçare e komandimit për këta prokurorë përfundoi, atëherë KLP me Vendimin nr. 36, datë 05.02.2020, shpalli fillimin e procedurave për plotësimin e gjashtë pozicioneve në KLP përmes procedurës së komandimit të prokurorëve, në pozicionin e këshilltarit për një periudhë komandimi prej 3 vjetësh.</p> <p>Me Vendimet nr. 66 deri në 71, datë 24.02.2020, KLP kreu komandimet e prokurorëve në pozicionin e këshilltarit në KLP.</p> <p>Buxheti vjetor i alokuar ka shumën prej 152 324 (në mijë lekë), ndër të cilat 17 000 (në mijë lekë) janë parashikuar për investime.</p> <p>KLJG:Në total nga momenti i miratimit të strukturës deri në mars 2020, janë rekrutuar 24 personel i ri për KLJG, duke mundur rritjen e efikasitetit në çdo njësi, si dhe duke rritur cilësinë e përpunimit të</p>	

							<p>akteve, shkresave, si dhe përmirësim e ndjeshëm të afateve kohore të realizimit të këtyre detyrave. Megjithatë, nevoja për burime njerëzore nuk është adresuar plotësisht, për shkak se infrastruktura aktuale nuk krijon mundësinë që KLGJ të funksionojë me një strukturë të plotë. Procesi i rekrutimeve për të përbushur strukturën e miratuar të KLGJ-së me 125 punonjës dhe për pasojë funksionimin e saj me kapacitet të plotë, do të vijojë me intensivisht në momentin e transferimit tek mjediset e Polit të Drejtësisë, ku do të sigurohen hapësirat e nevojshme të punës.</p> <p>Analiza mbi normën e likuidimit të çështjeve është bërë në shkallë vendi në kuadrin e raportit vjetor të KLGJ-së, për vitin 2018 dhe është në proces analiza për vitin 2019. Për sa i përket veprimeve konkrete për rritjen e normës të likuidimit të çështjeve, KLGJ ka ndërmarrë një numër masash në lidhje me delegimet e gjyqtarëve dhe transferimin e përkohshëm. Po në këtë drejtim shërben edhe Vendimi Nr.78 datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.</p> <p>KLGJ, pas plotësimit të kuadrit nënligjor (Rregullat për kriteret dhe procedurën për promovimin e magistratëve në Gjykatën e Lartë - vendimi nr. 75, datë 23.05.2019; rregullat për kriteret dhe procedurën për emërimin e jo gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë - vendimi Nr.102 datë 5.07.2019), hapi procedurat e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur. Në përfundim të procedurave të kandidimit për secilin nga pozicionet e lira të shpallura, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për të gjithë konkurrentët, si dhe vlerësimin sipas meritave të kandidatëve të kualifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e tre kandidatëve, me vendimet nr. 110, 111 dhe 112 datë 27.2.2020, mbi bazën e të cilëve u emëruan si Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë respektivisht me dekretet nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020, të Presidentit të Republikës.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor po vijon procedurën e</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin për pozicionin e katërt nga radhët e juristëve të spikatur, si edhe vendosi në mbledhjen e datës 26.2.2020 hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për plotësimin e pozicioneve të tjera të lira në Gjykatën e Lartë.</p> <p>Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” i hapi rrugë edhe promovimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë. Kështu, me Vendimin nr. 82, 83 dhe 84 datë 26.02.2020, ka vendosur Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative, me Vendimin nr. 85, 86 dhe 87, datë 26.02.2020, ka vendosur Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës civile.</p>
<p>2. Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe të policisë gjyqësore dhe shpërndarjen e gjykatave në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura gjyqësore me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar qasje në drejtësi.</p>	KLGJ	Zbatimi i hartës gjyqësore.	762 500			Në proces	<p>KLGJ: KLGJ raporton se është në proces të përcaktimit të juridiksionit territorial dhe përmasave të gjykatave. Grupi i ndërinstitucional i punës, (i përbërë nga përfaqësues nga gjykatat e vendit, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si: Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të Gjithë” - JUST/USAID), bazuar në metodologji dhe standarde ndërkombëtare, pas një analize paraprake, ka përfunduar draftin e hartës së re gjyqësore, e cila pritet të diskutohet brenda 6-mujorit të parë të 2020.</p> <p>MD: Nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, është propozuar përcjellja për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimi “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”. Nisma është planifikuar në tremujorin e tretë të vitit 2020.</p>
<p>3. Ngritja e një plani pune për reduktimin e numrit të çështjeve të mbartura.</p>	KLGJ/GJL	Zbatimi i Planit të Veprimit.	2332			Në proces	<p>KLGJ: Me qëllim marrjen e masave emergjente për uljen e numrit të lartë të stokut të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Lartë, me Vendimin Nr.317 datë 19.12.2019, vendosi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë.</p>

							<p>të shqyrtohet nga komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.</p> <p>Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë:Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë krahas marrjes së masave për organizimin dhe funksionimin e institucionit, gjatë periudhës kohore 01.02.2020-30.03.2020 edhe pse në mungesë të burimeve njerëzore, ka ndërmarrë veprime administrative lidhur me shqyrtimin, verifikimin, si dhe hetimin e pretendimeve të paraqitura nga ana e personave fizikë ose juridikë lidhur me veprimet apo mosveprimet e magistratëve, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore.</p> <p>Konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në proces administrimi dhe shqyrtimi fillestar të një volumi të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magistratëve, të cilat janë dorëzuar gjatë periudhës tranzitore 2017-2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose Prokurorisë së Përgjithshme. ILD gjithashtu nga data 01.02.2020, datë në të cilën konsiderohet fillimi i veprimtarisë së tij, po administron të gjitha ankesat e paraqitura pranë tij nga ana e personave fizikë, ose juridikë.</p> <p>Krahas veprimeve të mësipërme, prioritet i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është shqyrtimi dhe vlerësimi me seriozitet i të gjitha çështjeve të cilat kanë një impakt publik. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi është njohur nga media mbi ngjarjen e ndodhur në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (313) “Jordan Misja”, ka nisur menjëherë procesin për verifikimin e fakteve të nevojshme, si dhe sigurimin e dokumentacionit përkatës për të vlerësuar nëse ka vend për fillimin e hetimit disiplinor. I.L.D, gjithashtu ka iniciuar kryerjen e një inspektimi tematik pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit, si dhe të zyrave të prokurorive pranë tyre, mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht” për periudhën kohore 01.01.2017 - 31.01.2020. Si dhe në një rast, ka nisur hetimin disiplinor ndaj një magjistriti për kryerjen e shkeljeve disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit.</p> <p>Ecuria e këtyre proceseve është ngadalësuar për shkak se institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është hasur me mungesën e burimeve njerëzore për shkak të pezullimit të procedurave të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>rekrutimit të punonjësve nga ana e Departamentit të Administratës Publike, si pasojë e pandemisë botërore COVID-19, si dhe mungesës së inspektorëve. Aktualisht nga ana e Këshillave janë komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm dy magistratë. Në të njëjtën kohë, pezullimi i veprimtarisë së gjykatave, ka ndikuar në krijimin e vonesave për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e tyre.</p> <p>Nisur nga përcaktimet ligjore se, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore, bazuar në nenin 119 e vijues, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, dhe Ministrisë së Drejtësisë të dërgohen pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ankesat e depozituara nga çdo person fizik, ose juridik lidhur me pretendimin për shkeljet e kryera nga ana e magistratëve; - Dosjet disiplinore në proces hetimi; - Problematikat e konstatuara që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; - Çështjet lidhur me inspektimet tematike dhe institucionale sipas kërkesave të nenit 194, pika 4, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar. <p>Puna është fokusuar në administrimin e ankesave të qytetarëve dhe të institucioneve. Deri tani, është bërë e mundur të kthehet përgjigje pranuese e kërkesave të paraqitura në 300 raste dhe verifikim i rreth 20 rasteve.</p> <p>Konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në proces administrimi dhe shqyrtimi fillestar të në volumni të madh ankesash, lidhur me veprimtarinë e magistratëve, të cilat janë dorëzuar gjatë periudhës tranzitore 2017-2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose Prokurorisë së Përgjithshme.</p> <p>Prioritet i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është shqyrtimi dhe vlerësimi me seriozitet i</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

							të gjitha çështjeve, të cilat kanë një impakt publik.
2. Hartimi dhe publikimi i standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes për magistratët si dhe monitorimi i zbatimit të tyre.	KLJG/ KLP	Monitorim i zbatimit të standardeve. Zbatimi i procedura ve.	17 250	17 250			<p>KLJG:Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e rregullave dhe Kodit të Etikës dhe për monitorimin e tyre, dhe specifiktisht Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, po konsideron me prioritet përgatitjen e draftit të parë të standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, sipas Ligjit nr. 115/2016.</p> <p>Me vendimin nr. 208, datë 11.10.2019, KLJG caktoi një gjyqtar si këshilltar për etikën.</p> <p>KLP:Nuk ka ende zhvillime për periudhën e raportimit.</p>
3. Hartimi i bazës nënligjore mbi procedurat dhe kriteret e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave të propozuara disiplinore ndaj gjyqtarëve e prokurorëve.	KLJG KLP	Zbatimi i procedurave		7 500			<p>KLJG:Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e përcakton Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, si dhe për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve.</p> <p>Ligji 48/2019, datë 18/07/2019 plotësoi boshllëkun ligjor mbi përkufizimin e shkeljeve disiplinore. Në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLJG “Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave”, është në proces edhe përgatitja e projekt-aktit për elementët kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore. (Në funksion të vendosjes së standardeve që garantojnë një sistem gjyqësor sa më profesional dhe etik, KLJG ka në proces hartimin e këtij projekt akti, fokusi i të cilit është përcaktimi i organeve dhe procedurave disiplinore si dhe përcaktimi në mënyrë të qartë i elementeve kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore.)</p> <p>KLP:Nuk ka ende zhvillime për periudhën e raportimit.</p>

4. Përmirësimi i transparencës së procesit të vlerësimit të masave disiplinore.	KLGJ	Anonimizimi dhe publikimi në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve.	8 000	3 750			Në proces	KLJGJ: Ashtu sic përmendet më lart, rregullorja mbi procedurat dhe kriteret e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave të propozuara disiplinore ndaj gjyqtarëve, që është në proces përgatitje, përfshin edhe elementin e transparencës dhe të anonimizimit të të dhënave.
5. Reduktimi i vonesave në vlerësimin vjetor periodik të magistratëve.	KLGJ	4 vjet vonesë (backlog) KLGJ ka vlerësuar të paktën 90% të gjyqtarëve sipas planit vjetor tëVLERESIMIT	57 150		1 500 (mijë lekë)		Në proces	<p>KLGJ, sipas përcaktimeve Kushtetuese (neni 147/a i Kushtetutës) dhe neneve 68-99 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë” i ndryshuar, ka detyrim kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional periodik të gjyqtarëve. Në këtë kuadër, janë hartuar edhe aktet nënligjore për realizimin e këtij procesi me synim (i) përmirësimin e vazhdueshëm të aspektit etik dhe profesional të gjyqtarëve; (ii) vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve; (iii) zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe (iv) identifikimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues. Krijimi i standardeve në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, realizuar në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë (Euralis dhe Këshilli i Evropës), është mbajtur në konsideratë në 3 aktet më kryesore të deritanishme, lidhur me këtë qëllim, të miratuara nga KLGJ dhe që i përkasin skemës së vlerësimit (Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, nr. 264, datë 21.11.2019 dhe nr.120 datë 05.03.2020).</p> <p>Programi i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve për vitin 2020 është miratuar me vendimin Nr.276 datë 10.12.2019 dhe parashikon vlerësimin e 121 gjyqtarëve përgjatë vitit 2020. Duke marrë shkas nga vijimi i situatës së fatkeqësisë natyrore në vend e krijuar nga virusi COVID-19, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori vendimin për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të çështjeve urgjente. Për rrjedhojë, kjo do të ndikojë edhe në procesin e vlerësimit të gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.</p>

Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit dhe formimit ligjor si edhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave
Nën-objektivi 2/a: Kualifikimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit të gjykatës sipas standardeve/kërkesave evropiane

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020	
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë			
1. Thellimi dhe zgjerimi i aktivitetit të Shkollës së Magjistraturës në drejtim të rekrutimit dhe ofrimit të programeve trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe kategoritë e tjera të personelit të gjykatave dhe prokurorëve nëpërmjet përmirësimit të programit të rekrutimit dhe kurrikulave për kandidatët për magjistratë, si dhe krijimi i kurrikulave të reja dhe moduleve të trajnimit për kategoritë e tjera.	SHM	Përmirësi m kurrikula për vitin e dytë të formimit fillestar për kandidatët magjistrat ë/ndihmës ligjorë. Zhvillohen 3 kurrikula të reja dhe të paktën një kurs online për trajnimin e vazhdueshëm		2 681			Në proces	Shkolla e Magjistraturës: Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Qendrën Hollandeze të Studimeve dhe Trajnimit Gjyqësor (SSR) dhe Misionin Euralius V, pas miratimit të kurrikulës mësimore të vitit të parë të Programit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarë ndihmës ligjorë, ka filluar procesin e përmirësimit të kurrikulës mësimore të vitit të dytë të Progrsmit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë. Ky proces drejtohet nga Drejtori, Këshilli Pedagogjik dhe pedagogët përgjegjës të lëndëve të vitit të dytë të Programit të Formimit Fillestar dhe pritet të përfundojë në fund të muajit Shtator 2020, kur dhe mund të miratohen këto kurrikula nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës.	
2. Transformimi gradual i Shkollës së Magjistraturës në një qendër burimore dhe pikë takimi për të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ofrimi i kushteve optimale të trajnimit për magjistratët dhe personelit të gjykatave. Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore për Shkollën e Magjistraturës.	KLGJ, SHM	Përfundim i i fazës së parë të punimeve. Raport vjetor progresi.	798 345		306 345 ('19)			Në proces	KLGJ: Mendojmë të rishikohet roli i KLGJ si institucion përgjegjës, pasi në bazë të ligjit nr. 115/2016 “për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara në ligj: KLGJ nuk ka rol as në përshtatjen e ambienteve të shkollës dhe as në procedurat e prokurimit (<i>dy objektivat për vitin 2019</i>). Për sa i përket bashkëpunimit mes KLGJ dhe SHM, vlen të theksohet që KLGJ ka dhënë opinion në mbledhjen plenare të datës 2 korrik 2019 për draft programin tematik 2019-2020 të ShM si dhe kurrikulat e trajnimit 8 javor për kancelarët e gjykatave. Gjithashtu, një pjesë e anëtarëve të KLGJ kontribuojnë edhe në rolin e lektorëve të ftuar në trajnimin fillestar në SHM, si edhe të ekspertëve në trajnimin vazhdueshëm të gjyqtarëve.

								<p>SHM:Shkolla e Magjistraturës duke filluar nga muaji tetor 2019 është zhvendosur, përkohësisht, në ambiente të reja, të cilat plotësojnë pjesërisht kërkesat për zhvillimin normal të programit të formimit fillestar të kandidatëve për magistratë dhe kandidatëve për këshilltar e ndihmës ligjorë, kancelarëve, avokatëve të shtetit, gjithashtu dhe të nevojave të programit për trajnim të vazhduar të magistratëve në detyrë. Në këto ambiente i jepet zgjidhje e përkohëshme edhe nevojave për hapësira më të përshtatshme pune për stafin akademik dhe administrativ të Shkollës. Me VKM nr.234, dt. 17.04.2019, Shkolla e Magjistraturës do të ushtrojë veprimtarinë e saj në të njëjtën godinë me KLGJ dhe</p> <p>KLP: Për periudhën Janar-Shtator 2019 nuk ka asnjë kosto nga ana e Shkollës.</p> <p>Në vijim të procedurave për ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magjistraturës, në respektim të afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me studion projektuese, në dhjetor të vitit 2019 është dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), Projekti i Zbatimit për ndërtimin e saj. Vlera e parashikuar e ndërtimit dhe e mobilimit është rreth 529.923.000 lekë.</p> <p>Per vitin 2020, nuk është akorduar fond investimi nga Ministria e Financave për fillimin e procedurave të prokurimit për ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magjistraturës.</p>
3. Rritja dhe përmirësimi i punës kërkimore shkencore nëpërmjet pasurimit të fondit të bibliotekës dhe sigurimi i aksesit në bibliotekat digjitale.	SHM	100 libra literature vendase dhe të huaj, botime shkencore	6 048; 2 170 ('19); 1 939 ('20); 1 939 ('21)				Në proces	<p>Shkolla e Magjistraturës, për periudhën Janar 2020 – Mars 2020, ka botuar 1 numër të Revistës “Jeta juridike”, konkretisht nr. 3 të vitit 2019, në 300 kopje.</p> <p>Deri më tani është investuar në pasurimin e bibliotekës së Shkollës. Konkretisht, fondi i bibliotekës së Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Janar 2020-Mars 2020, është rritur me 20 njësi bibliotekare. Të gjitha këto njësi janë dhuruar nga partnerë të Shkollës.</p>
4. Trajnime dhe kualifikime për ngritjen e kapaciteteve këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër	GJK	Seanca trajnimesh për aspektet e reja të juridiksionit	23 700		1.500.000		Në proces	<p>Ka vijuar procesi i trajnimeve dhe kualifikime për ngritjen e kapaciteteve këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi. Seanca trajnimesh për gjyqtarë; Seanca trajnimesh për staf/personel. Analiza e nevojave për trajnim për këshilltarët aktualë dhe të</p>

të reformës në drejtësi.								rinj;Seanca trajnimi për: aspektet e reja të juridiksionit të GJK (për gjyqtarë dhe për personel). Gjithashtu lidhur me rritjen dhe përmirësimin e punës kërkimore shkencore nëpërmjet pasurimit të fondit të bibliotekës dhe sigurimi i aksesit në bibliotekat digjitale. GJK do të vijojë të investojë në pasurimin e bibliotekës së saj. Konkretisht, fondi i Bibliotekës, për periudhën Janar-Dhjetor 2019, është shtuar me 21 njësi bibliotekare, të cilat janë literaturë e huaj. Për periudhën janar 2020-mars 2020 GJK është në fazën e përzgjedhjes së literaturës. Ndërkohë GJK në bashkëpunim me OSCE, po realizojnë Planin Strategjik i Gjykatës Kushtetuese, si dhe hartimin e rregullores së re së punës, të Gjykatës Kushtetuese e cila do t'i përshtatet ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore.
Objektivi 3: Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen në gjykatë në përputhje me standardet evropiane Nën - objektivi 3/a: Përmirësimi i transparencës në funksionimin e sistemit gjyqësor (Shënim: masat në lidhje me efikasitetin janë përfshirë nën Objektivin 1b)								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1.Rritja e marrëdhënieve të gjykatave me median dhe sigurimi i qasjes së publikut në informacione për rastet me interes publik.	KLJG	Trajnimi i këtij grupi target. Sigurimi i mjeteve logjistike	500	4 000			Realizuar	KLJG, me vendimin nr. 68 datë 24.04.2019, ka përcaktuar anëtarin për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun. Gjithashtu, KLJG, me urdhrin nr. 19 datë 09.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, ka miratuar "Programin e Transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Me vendimin Nr. 126, datë 19.07.2019, KLJG miratoi Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë për vitet 2019-2020, ku Objektivi nr. 5 i tij është përmirësimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve dhe publikut, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të qartë komunikimi. Aktualisht, KLJG, po bashkëpunon me partnerët e Projektit "Drejtësi për të gjithë" (USAID) për hartimin e një strategjie komunikimi, si edhe për hartimin e Rregullores "Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median".

								<p>KLGG, me vendimin Nr.280 datë 10.12.2019, ka caktuar 8 gjyqtarët për mediat, në çdo juridiksion apeli. Në datën 22 janar 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi së bashku me Projektin “Drejtësi për të gjithë” (USAID), një aktivitet me gjyqtarët për mediat, nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun, si edhe me disa gazetarë që mbulojnë çështjet e drejtësisë.</p> <p>Me ndihmën e projektit u mundësua edhe vënia në funksionim e faqes së re të internetit http://klgj.al/ ku pasqyrohet në mënyrë transparente e gjithë veprimtaria e KLGG.</p>
<p>2.Publikimi elektronik në kohë i vendimeve të gjykatave si dhe analizave vjetore të gjykatave / raporte efiçence dhe përditësimi i rregullt i faqes gjykata.gov.al.</p>	KLGG	Zbatimi në masën 100%	18 000				Në proces	<p>KLGG raporton se për periudhën e raportimit, nga ana e gjykatave kryhet publikimi i të gjitha vendimeve, por Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve ICMIS nuk mundëson procesin automatik të fshirjes së të dhënave personale në tekstin e vendimeve gjyqësore. Aktualisht anonimizimi i të dhënave kryhet manualisht, konsumon shumë kohë fizike dhe kërkon burime njerëzore shtesë.</p> <p>Faqja gjykata.gov.al hostohet nga AKSHI dhe jo nga KLGG.</p> <p>KLGG në bashkëpunim me Projektin Justice for All, është duke punuar për krijimin e një portali elektronik të unifikuar të sistemit gjyqësor ku KLGG dhe të gjitha gjykatat do të kenë faqen e tyre të dedikuar. Ky portal do të mundësojë një transparencë më të mirë të veprimtarisë gjyqësore të gjykatave.</p>
<p>Nën-objektivi 3/b: Përmirësimi i aksesit në sistemin e drejtësisë</p>								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 <i>(E realizuar / në proces / e parealizuar)</i>	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		

<p>1. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF) është krijuar dhe ka funksionalitet të plotë.</p>	<p>MD</p>	<p>Krijimi i regjistrit elektronik funksional për menaxhim in e të dhënave për ndihmën juridike parësore dhe dytësore; Kalendar i mbajtur për fushatat ndërgjegjë suese;</p>	<p>86 500</p>				<p>Në proces</p>	<p>Euralius është duke asistuar Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, në krijimin e prototipit të Case Management System.</p> <p>Kjo masë është në proces dhe parashikohet që brenda vitit 2020 të realizohet.</p>
<p>2. Sistemi i Ndhmës Juridike Parësore ka funksionalitet të plotë.</p>	<p>DNJF</p>	<p>Mbulohen 90% e nevojave për ndihmë parësore në shkallë vendi 4 qendra të tjera të shërbimit të ndihmës juridike; Janë zhvilluar fushta ndërgjegjë suese Ngritja dhe funksioni mi i klinikave ligjore pranë universiteve private; Program të trajnimit vazhdues për ofruesit e ndihmës juridike (ASPA; donator);</p>	<p>29 000</p>			<p>453,744</p>	<p>Në proces</p>	<p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas:Në zbatim të kësaj mase, lidhur me plotësimin e kuadrit nënligjor, në vitin 2019 janë miratuar pjesa më e madhe e akteve nënligjore në zbatim të ligjit 111/2017.</p> <p>Gjatë këtij viti, në proces miratimi mbetet akti nënligjor që lidhet me përcaktimin e tarifave të avokatëve që do të orfojnë ndihmë juridike dhe përzgjedhja e listës sipas parimit të rotacionit. Aktualisht lidhur me përcaktimin e tarifave Ministria e Drejtësisë ka dërguar aktin pranë MFE dhe është duke u punuar mbi një dakordësi e miratim të aktit. Gjithashtu, lidhur me caktimin e listsës sipas parimit të rotacionit, MD po komunikon me DhASh për një akt final që do të miratohet.</p> <p>Janë ngritur dhe funksionojnë 3 Qendra të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, përkatësisht në qytetet e Elbasanit, Durrësit dhe Fierit, në bashkëpunim ndërmjet MD, UNDP dhe OSFA. Gjithashtu, pranë Ministrisë së Drejtësisë vijon të funksionojë zyra ligjore që ofron ndihmë juridike. Ministria e Drejtësisë është në proces të hapjes së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore për qytetin e Tiranës.</p> <p>Përgjatë vitit 2020, DNJF në objektivat dhe planin e saj të punës synon hapjen e disa qendrave të reja në qytetet e Lushnjës, Kukësit e Gjirokastrës, si dhe në disa qytete të tjera për të cilat është duke bashkëpunuar me UNDP. Për krijimin e qendrave, DNJF vijon bashkëpunimin me bashkitë respektive për ofrimin e ambjenteve si dhe me ADISA-n, për të krijuar mundësitë e ambjenteve sa më të</p>

							<p>përshatshme në funksion të aksesit të qytetarëve.</p> <p>Procedura për autorizimin e OJF-ve që do të ofrojnë ndihmë juridike është në proces. Aktualisht është publikuar njoftimi për hapjen e procedurave të aplikimit për autorizimin e OJF-ve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti. Procesi i shqyrtimit të aplikimeve dhe dokumentacionit është në proces dhe do të vijojë deri në përfundim të procedurës ligjore. <i>(procedura është shtyrë për një moment të dytë si pasojë e situatës së krijuar nga covid-19).</i></p> <p>Klinikat që kanë shprehur dakordësinë për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Universiteti i Tiranës; - Kolegji universitar Ëisdom - Kolegji universitar Luarasi - Kolegji universitar Beder - Universiteti i Vlorës - Universiteti Europian i Tiranës - Universiteti Mesdhetar - Albanian University <p>Aktualisht, DNJF është në proces të nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me seclien nga klinikat e ligjit që operojnë pranë IAL-ve.</p> <p>Lidhur me fushatat e ndërgjegjësimit, DNJF, bazuar në Ligjin nr 111/2017, ka ndër të tjera, detyrimin ligjor për të zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për ndihmën juridike falas si dhe ngarkohet me përgjegjësinë e edukimit ligjor të publikut duke mos u ndalur vetëm tek sistemi i ndihmës juridike falas por dhe më gjerë. Nisur nga ky detyrim ligjor, dhe nga aktivitetit konkret në këtë plan veprimi, DNJF gjatë tre-mujorit të parë ka realizuar disa aktivitete</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>me karakter ndërgjegjësues, të cilat do të vijojnë përgjatë gjithë vitit, si një detyrim që shtrihet në kohë dhe është në proces.</p> <p>Aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara në tremujorin e parë të 2020, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fushatë ndërgjegjësimi në qytetin e Elbasanit mbi zbatimin në praktikë të Ligjit 111/2017, për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, me aktorët kryesorë subjekte të këtij ligji, si dhe pjesëmarrës nga shoqëria civile. - Sesion informues/ seminar i zhvilluar pranë Qendrës së Re-Integrimit të Miturve, Kavajë, me qëllim ndërgjegjësimit dhe edukim të një prej kategorive të veçanta të ligjit të ri të ndihmës juridike. <p>Gjatë këtij viti, sipas planit të punës së DNJF, janë parashikuara një sërë aktivitetesh ndërgjegjësuese të cilat do të kenë në fokus edukimin ligjor të miturve në gjimnaze, duke filluar me qytetin e Tiranës, Elbasanit, zonat të clat janë më pak të informuara referuar të dhënave që disponohen nga vetë këto gjimnaze. Gjithashtu, aktivitetet do të shtrihen edhe në IEVP-të si duke patur në fokus edukimin ligjor të grave. Një tjetër aktivitet që parashikohet është dhe edukimi ligjor, në formë seminari këshillimi juridik për gratë e dhunuara, duke qënë se janë një nga kategoritë vulnerabël së cilës ky ligj i jep prioritet.</p>
3. Sistemi i Ndhmës Juridike Dytësore ka funksionalitet të plotë.	DNJF; Gjykatat; DHKA; SHM	75% e nevojave janë përmbushur, përfshi edhe grupet vulnerabël në të njëjtën masë; Janë zhvilluar fushata ndërgjegjësuere;	135 000		DNJF: Për periudhën Janar – Mars 2020 buxheti për ndihmë juridike	Në proces	<p>DNJF: Lidhur me plotësimin e kuadrit nënligjor, <i>(shih shpjegimin më lart, masa 2 në këtë nënobjektiv).</i></p> <p>Sa i përket përzgjedhjes së avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore, pranë DNJF ka ardhur lista e avokatëve për vitin 2020, dhe kjo listë është e publikuar në faqen e Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>DNJF gjatë këtij tre-mujori ka filluar procesin e nënshkrimit të kontratave me avokatët, ofruar të</p>

					<p>dytësore:</p> <p>1 148 200 lek</p>		<p>ndihmës juridike dytësore. (Janë nënshkruar rreth 70 kontrata). Procesi i lidhjes së kontratave aktualisht është pezulluar si pasojë e situatës së pandemisë dhe do të vijojë në një moment të dytë.</p> <p>Lidhur me trajnimet e gjyqtarëve dhe avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, ky aktivitet vijon të jetë në proces dhe janë parashikuar në zbatim të tij zhvillimi i disa tryezave të përbashkëta me aktorët e përfshirë, përkatësisht me Shkollën e Magjistraturës, Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe ASPA-n. Me këto institucione do të bashkëpunohet në funksion të programeve trajnuese mbi ndihmën juridike falas.</p> <p>Lidhur me aktivitetet ndërgjegjësuese (<i>shih shpjegimin më lart, masa 2 në këtë nën objektiv</i>).</p> <p>DNJF: Për periudhën Janar – Mars 2020 buxheti për ndihmë juridike dytësore: 1 148 200 lekë.</p> <p>SHM: Shkolla e Magjistraturës raporton se miraton në çdo muaj shtator të vitit, kalendarin e trajnimeve të një viti akademik. Tema e “Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti” është përfshirë në kalendarin e trajnimeve për vitin akademik 2019-2020, në datën 20-21 nëntor 2019. Në këtë trajnim morën pjesë 12 gjyqtarë dhe 1 Avokat Shteti.</p> <p>DHKA: Është kryer përzgjedhja e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në bazë të rregullave të përcaktuara në Ligjin për Ndihmen Juridike të garantuar nga Shteti. Është organizuar shorti në mjediset e DHASH për listimin dhe renditjen e avokatëve të ndihmës juridike për Dhomën e Avokatisë Tiranë dhe dhomat lokale. Lista pas shortit të hedhur i është dërguar dhomat lokale si dhe Ministrisë së Drejtësisë. Propozimet për tarifat e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike së bashku me relacionin përkatës i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë.</p>
<p>Objekti 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave antikorupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale</p> <p>Nën-objekti 4/a: Përmirësimi i efikasitetit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë penale sipas standardeve evropiane</p>							
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto mijë lekë) (në 2019 - 2021	Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020	

			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	(E realizuar / në proces / e parealizuar)	
1. Monitorimi i rasteve të paraburgimit për vepra të vogla si dhe të numrit të të miturve në paraburgim (nga procesi i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarëve dhe procesi disiplinor).	KLJGJ	Identifikimi vjetor i rasteve, analiza në nivel makro dhe nxjerrja e rekomandimeve për institucionet përkatëse.	1800				Në proces	Skema e re e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve është miratuar, (<i>shih Nën-objektivi 1/c, pika 5</i>). Por vënia në funksionim të plotë është aktualisht e pezulluar, për shkak të situatës së fatkeqësisë natyrore në vend, të krijuar nga virusi COVID-19, Sistemi aktual i menaxhimit të çështjeve nuk e gjeneron një statistikë të tillë. Në kuadër të përgatitjes së raportit vjetor 2019, për vetë sensitivitetin e çështjes, nga gjykatat është kërkuar raportimi për dënimet alternative për çështjet penale me të mitur.
2. Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme që synojnë: a) Rritjen e eficiencës së hetimit; b) Rritjen e aplikimit të masave të sigurimit të ndryshme nga masa me arrest në burg për veprat	PP	A) Rritja 2 % çështjeve dërguar në gjykatë për vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore, krahasuar me vitin 2019 B) Rritja 10 % e kërkesave të prokurorit për masa alternative sigurimi të ndryshme nga ajo me burg, krahasuar me 2017 baseline	2 000				Realizuar	Prokuroria e Përgjithshme: Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe kuadrit ligjor për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe inicimin në Kuvendin e Shqipërisë (Komisionin e Ligjeve) për miratim të një shtese në nenin 287 të K.Penal, në përqasje me nenin 9 (3) të Konventës së KiE-së “Për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimi i terrorizmit” e ratifikuar me ligjin nr.9646/2006, sipas rekomandimit për Shqipërinë nga Konferenca e Palëve të kësaj Konvente të KiE-së me 22/23 Tetor 2019, ashtu dhe në kuadër të përafritimit të këtij neni të K.Penal me Direktivën (BE) 1673/201 të Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 Tetor 2018 “Për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit”. Udhëzim i Përgjithshëm nr.2, datë 10.03.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19” Udhëzim i Përgjithshëm nr.3, datë 19.03.2020 “Për disa masa procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes COVID-19” Udhëzim i Përgjithshëm nr.4, datë 24.03.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19” Udhëzim i Përgjithshëm nr.5, datë 08.05.2020 “Mbi

<p>penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore (deri në 5 vjet burgim)</p>								<p>masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”</p> <p>Analiza e treguesve për vitin 2019</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë për veprat penale të trafiqeve është rritur 19 % në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. • Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë lidhur me krimin e organizuar është rritur 117 % në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. • Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë lidhur me vrasjet me dashje (76-79/c) është rritur 54 % në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. <p>http://www.pp.gov.al/web/kuvendit_raporti_vjetor_2019_28_3_2020_pp_perf_1864.pdf</p>
<p>3. Garantimi i kushteve të punës sipas standardeve bashkëkohore nëpërmjet:</p> <p>a) Shtimi i stafit mbështetës në funksion të prokurorit;</p> <p>b) Investime në infrastrukturë; Ndërtime të reja; Rikonstruksion;</p> <p>c) Trajnimi vazhdues i oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit të nëpunësve civilë.</p>	<p>PP, KLP, PP</p>	<p>Ulje e ngarkesës mesatare për prokuror me 10 %krahasuar me ngarkesën e vitit 2018</p> <p>Trajnim vazhdues profesional</p>	<p>205 900;</p> <p>për n/masën e ndarë:</p> <p>a)192 000;</p> <p>c) 13 900</p>	<p>99 385; për n/masën b) e ndarë;</p> <p>b) 2 085: 97 300</p>			<p>Në proces</p>	<p>PP: Janë rekrutuar gjatë periudhës raportuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Drejtor me status civil - 1 përgjegjës sektori - 1 specialist finance <p>b) Për vitin 2020 janë planifikuar fonde në total për rikonstruksione 63,830 mijë lekë, nga të cilat shuma 58,712 është planifikuar për rikonstruksion të dy ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e PP dhe Prokuroria e shkallës së Parë Kurbin. Ndërsa shuma prej 5.118 mijë lekë është planifikuar për 11 prokurori dhe përfshin blerje kangjella e dyer të blinduara në kuadër të ruajtjes së dokumentave.</p> <p>Për shkak edhe të situatës aktuale, nuk ka zhvillime për periudhën raportuese.</p> <p>c) Kanë kryer trajnimin detyrues 2 nëpunës civil të cilët kanë qenë në periudhe prove.</p> <p>Aktualisht janë pezulluar proceset e trajnimeve si masë parandaluese për shkak të situatës së pandemisë.</p> <p>Lidhur me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore, Komisioni i Policisë Gjyqësore dhe Shkolla e Magjistraturës kanë rënë dakort për nënshkrimin e</p>

								marrëveshjes për kryerjen e trajnimit vazhdues të tyre nga Shkolla e Magjistraturës. KLP: Nuk ka ende zhvillime për periudhën e raportimit.
4. Rritja e efikasitetit të procesit penal, nëpërmjet: a) Realizimi i procesit të decentralizimit të përgjimit të komunikimeve elektronike pranë prokurorive; b)Zgjerimi i kapaciteteve për përgjimin aktiv.	PP	Përgjimet realizohet në secilën prokurori		231 130			E përealizuar	PP: Nuk ka zhvillime për periudhën raportuese.

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar procedurat dhe lehtësirat moderne të sistemeve elektronike për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar
Nën-objektivi 5/a: Përmirësimi i gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturë

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1.Krijimi i një platforme të unifikuar IT për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit. (përfshirë platforma për menaxhimin e çështjeve) <u>(Në funksion dhe të objektivit 1a)</u>	KLJG	Projektimi , prokurimi i sistemi të ri të menaxhim it të çështjeve në gjykata (ICMIS të ri).		469 350			Në proces	<p>Këshilli raporton se ka ndërmarrë masat e nevojshme për të mundësuar transferimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe kontratat përkatëse nga MD. Në funksion të këtij objekti, theksojmë se KLJG ka ngritur grupin e punës , detyra e të cilit ishte marrja në dorëzim e sistemit të menaxhimit të çështjeve. Aktualisht ky sistem është marrë në administrim nga KLJG në muajin qershor të 2019. Gjithashtu, është bashkëpunuar me MD duke dhënë opinion lidhur me projektvendimit për ngritjen e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Gjithashtu raportohet se nuk është miratuar ende ngritja e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë, gjë e cila pengon përbushjen e masave lidhur me zhvillimin e një programi pilot për gjykatat.</p> <p>Në zbatim të Urdhërit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 232, datë 4.11.2019“Për ngritjen e Grupit të Punës, për kryerjen e një studimi, në lidhje</p>

								me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve në gjykata”, u realizua studimi dhe Këshillit i’u paraqit raporti analitik, duke renditur problematikat e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata, sipas kategorive të prioriteve, për t’u mbajtur parasysh për përmirësimin e sistemit.
2. Krijimi i qendrës së centralizuar të mbështetjes së funksionimit të TIK (ITOSC) që do të qeverisë sistemet TIK të gjykatave, KLGJ, KLP, ILD.	MD, KM, Qendra TIK	QENDRA ESHTË NE FUNKSIONIM TE PLOTE.		70 803			Në proces	MD: Në lidhje me realizimin e kësaj mase, nga ana Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit është hartuar projektvendimi “Për krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”. Aktualisht projektvendimi i është nënshtruar procesit të konsultimit të brendshëm (ministrinë e linjës dhe organe të administratës publike), janë mbajtur disa takime me përfaqësues të Euralius dhe Justice for All, me synimin e dakordësimit të një drafti. Aktualisht, drafti është në fazë ripunimi në kuadër të komenteve dhe më pas do të vijojë bashkërendimi për mendimet e ardhura.
3.Blerje dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike për gjykatat	KLJGJ, Gjykatat	96%	175 000				Realizuar	KLJGJ: Blerja dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike është realizuar nga të gjitha gjykatat sipas parashikimeve buxhetore.
4. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (KLJGJ/ILD/KLP) 4.1. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (SPAK/ GJKKKO)	KLJGJ, KLP, ILD SPAK/ GJKKKO	Sistemi i brendshëm (softi) i menaxhimit të brendshëm në funksion (i veçantë për çdo institucion) Vendosija/ instalimi I pajisjeve IT dhe vënja në funksion e tyre Sistemi i brendshëm (softi) i menaxhimit të brendshëm i zhvilluar (I VECANTE PER CDO INSTITUCION)		110 308, KLJGJ 43 515, KLP 44 640 ILD 22 153 234 675;			Në proces	ILD: Në mbështetje të nenit 147/d e vijues, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kreut IV, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjen e Zotit Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë” nga data 1.02.2020, është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D). Në funksion të përbushjes së detyrave të tij kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë menjëherë masat e nevojshme për organizimin dhe funksionin e këtij institucioni të ri. Ky proces po shoqërohet nga ana e ILD me identifikimin e kostove financiare, sigurimin e fondeve buxhetore, hartimin e strukturave organizative të personelit, rekrutimin e stafit, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tij. Për këtë qëllim, janë kryer të gjitha veprimet e para

				SPAK 227 970; GJKKKO 6 705			<p>për regjistrimin e institucionit të ri pranë organeve tatimore, sigurimin e mjeteve identifikuese, regjistrimin dhe publikimin e domainit (ild.al), hostimit të faqes zyrtare të institucionit (www.ild.al), si dhe pajisjen me llogari të postës elektronike zyrtare.</p> <p>Me qëllim fillimin sa më parë të veprimtarisë së institucionit në mbështetje të nenit 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar një strukturë organizative dhe organikë të përkohshme me 40 punonjës, për të cilët janë shpallur dhe po zhvillohen procedurat e rekrutimit të tyre.</p> <p>Institucion i ri i ILD, po përballet me një pengesë serioze, mungesën e infrastrukturës. Që prej krijimit, ILD është ende i pasistemuar, por është rregulluar në mënyrë provizore në mesin e KLGJ, me vetëm 1 (një) zyrë. Aktualisht pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë të punësuar 14 punonjës (1 inspektor dhe 13 nëpunës të administratës) dhe në pak javë do të bëhen 40.</p> <p>Pavarësisht mungësisë së ambienteve e personelit, puna e institucionit ka vijuar me ritëm të kënaqshëm, në përputhje me objektivat dhe prej datës 1 Shkurt kur ILD ka nisur punën ligjrisht, është analizuar, koordinuar dhe miratuar struktura e përkohshme; është propozuar dhe përcjellë për miratim në Kuvend struktura e përhershme e Institucionit, (dërguar kërkesa për miratim Kuvendit më datë 2 Mars 2020); është krijuar faqja zyrtare e internetit www.ild.al; janë përgatitur përshkrimet e punës dhe zhvilluar testimet për 8 pozicione pune dhe për 20 raste të tjera (përfshirë inspektorë dhe ndihmësinsektorë), për të cilët janë kryer fazat fillestare dhe rifilluan procedurat pas një pezullimi të përkohshëm nga COVID-19; është miratuar rregullorja dhe metodologjia e punësimit të inspektorëve jo-magjistratë; po përfundon hartimi i akteve standard të punës së inspektorëve, etj.</p> <p>KLJGJ: KLGJ ka siguruar për vitin 2019 pjesën</p>
--	--	--	--	---	--	--	--

								<p>kryesore të infrastrukturës elektronike të nevojshme. Procesi do të vijojë edhe në vitin 2020, në varësi edhe të transferimit të institucionit në godinën e Polit të Drejtësisë.</p> <p>Duke marrë shkas nga vijimi i situatës së fatkeqësisë natyrore në vend e krijuar nga virusi COVID-19, ky proces mund të shtyhet në kohë, për shkak të kufizimeve buxhetore me të cilat do të përballet edhe sistemi gjyqësor.</p> <p>GJPKKKO u ngritën si gjykata me vendimin e KLGJ nr. 286 datë 18.12.2019. Nevojat për pajisje elektronike dhe plotësimi i tyre do shqyrtohen dhe realizohen gjatë vitit 2020.</p> <p>KLP:Nuk ka ende zhvillime për periudhën e raportimit.</p> <p>GJPKKKO dhe Apelit: Gjkata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Apelit është e pajisur me infrastrukturën bazë të nevojshme për vazhdimësinë e punës. Për vitin 2020 është planifikuar një fond prej 400,000 lekë nga Buxheti i Shtetit për investim në përmirësimin e kësaj infrastrukture.</p>
<p>5. Investim sipas standardeve bashkëkohore në godinat e gjykatave</p> <p>5.1 Përmirësimi i infrastrukturës së godinave të gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë e Durrës, (rikonstruksion dhe ndërtimi i godinave të reja).</p>	<p>KLJGJ, Gjykatat</p>	<p>58%</p>	<p>352 000</p>				<p>E përealizuar</p>	<p>KLJGJ:Investimet madhore në godina kushtëzohen nga miratimi i hartës së re gjyqësore, si edhe nga vijimi i situatës së fatkeqësisë natyrore në vend e krijuar nga virusi COVID-19, që do të sjellë kufizim buxhetore edhe për sistemin gjyqësor.</p>
<p>6. Përmirësimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke reflektuar në të edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe trajnimi i stafit</p>	<p>PP</p>	<p>Sistemi përdoret 100 % nga përdoruesit dhe siguron besueshmëri të dhënash</p>		<p>40 230</p>			<p>E përealizuar</p>	<p>Nuk ka zhvillime për periudhën raportuese.</p>
<p>7. Krijimi i kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin e informacionit</p>	<p>PP, MD</p>	<p>Sistemi funksional është</p>		<p>9 730</p>			<p>Në proces</p>	<p>PP:Me iniciimin e MD për ngritjen e grupit të punës së përbashkët është ngritur grupi i punës me përfaqësues të PP dhe MD. Aktualisht po vlerësohen</p>

në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar								mundësitë teknike për ndërveprimin e sistemeve elektronike të MD me PP dhe kostoja përkatëse.
8. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme IT në DNJF	MD	Infrastruktura e IT-së mbulohet nga një kontratë mirëmbajtjeje		140 000			E përealizuar	Nuk ka zhvillime
9. Përgatitja e një sistemi të integruar për publikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në Fletore Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, për publikimin e legjislacionit të përditësuar, të kodeve dhe të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave.	QBZ AKSHI	Integrimi i ICMIS me publikimet elektronik e dhe plotësimi/përditësim i i sistemit	69 840				E përealizuar	Qendra e Botimeve Zyrtare: Për periudhën e raportimit janar 2020 - mars 2020 QBZ raporton se projekti për zhvillimin e sistemit të integruar të akteve ligjore dhe nënligjore në Fletoren Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, për publikimin e legjislacionit të përditësuar, të kodeve dhe të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave, tashmë ka përfunduar dhe pas implementimit të këtij sistemi që prej datës 29.03.2019 sistemi është në funksionim të plotë dhe ka kaluar në fazën e mirëmbajtjes për një periudhë 4 vjeçare. Aktualisht, deri në momentin e këtij raportimi sistemi i QBZ “Arkiva Elektronike” nuk ndërvepron me asnjë sistem tjetër, as me sistemin ICMIS. AKSHI: Në kuadër të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, neni 277, pika 5, ka përfunduar procesi i dorëzimit të të drejtave të pronësisë mbi “Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS)” nga Ministria e Drejtësisë për tek Këshilli i Lartë Gjyqësor, me 23.06.2019, dhe është KLGJ institucioni që e ka në menaxhim këtë sistem.
10. Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturale dhe institucionale të Arkivës Gjyqësore (ASHSGJ-së).	ASHSGJ	Mobilimi me rafta arkivore I arkivës së sistemit gjyqësor për pjesën tjetër	51 000				Në proces	Për periudhën janar 2020 - mars 2020 raportohet se lidhur me këtë aktivitet ka përfunduar hartimi i projektit. Procedura e prokurimit të rikonstruksionit të ASHSGJ-së është pezulluar për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.
11. Krijimi dhe funksionimi i sistemit elektronik të arkivës gjyqësore.	ASHSGJ	Funksioni mi i sistemit elektronik (hedhja e të dhënave)	28 800				E përealizuar	Për këtë projekt, ASHSGJ raporton se KLSH ka rekomanduar revokimin e kontratës. Për shqyrtimin e rekomandimit të KLSH është ngritur grupi i punës me qëllim analizimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet palëve. Për shkak të situatës së krijuar nga

							<p>marrëveshje, procesi i formimit profesional është zhvilluar mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat fizike dhe bazën materiale që disponojnë institucionet, si dhe llojet e kurseve profesionale që ofrohen nga DRFP. Për periudhën janar-shkurt 2020, kurset profesionale janë ofruar në 9 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 287 të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektrikist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldaturë.</p> <p>1.3Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën aktivitete të tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve gjatë janar 2020 - shkurt 2020 është 2756. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 192 tema sociale në muaj dhe 37 recensione librash. Gjithashtu, janë zhvilluar 365 aktivitete ri-integruese. Është nëzbatim një dokument politikash për trajtimin e të burgosurve dhe të parburgosurve sipas nevojave të tyre, si dhe programe edukuese për të burgosurit në prag lirim. Qëllimi i këtyre programeve është ri-integrimi i suksesshëm në shoqëri i të burgosurve dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste. Këto kurse janë ndjekur nga 22 të burgosur.</p> <p>MD:Projektligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të parburgosurve” është miratuar në mbledhjen e datës 23.10.2019, në Këshillin e Ministrave dhe mbetet e pritshme, miratimi tij në Kuvend, sipas kalendarit të punimeve.</p> <p>Pas miratimi të projektligjit do të mund të vijojë puna për nxjerrjen e akteve nënligjore.</p>
2. Ulja e mbipopullimit në IEVP-të në përputhje me standardet evropiane.	DPB	Reduktim i mbipopullimit në masën 2%	373 000			Realizuar	<p>Çështja e mbipopullimit në nivel të përgjithshëm në sistemin e burgjeve është një problematikë e zgjidhur. Kapacitet totale të sistemit të burgjeve janë 6106 vende dhe gjatë janar-mars 2020 janë trajtuar mesatarisht 5268 persona, prej të cilëve 267 shtetas me masë mjekësore mjekim i detyruar. Niveli i popullimit në muajin mars 2020 ka qenë mesatarisht -17% (-1059). Pra, sistemi i burgjeve në nivel të përgjithshëm ka qenë në kushtet e nënpopullimit.</p> <p>Krahasuar me vitin 2019, niveli i popullimit të</p>

							<p>burgjeve është ulur me 5%. Ulja e popullimit në burgje ka ardhur si rezultat izbatimit të Ligjit Nr.5/2020 “Për Dhënie Amnistie”, për të cilat janë marrë masat e duhura dhe të nevojshme për efektivitetin e aplikimit të tij në mënyrë sa më rigorozë, në të gjitha IEVP-të. Lidhur me amnistinë e vitit 2020, vlerësojmë se është ngjarja më e veçantë për kategori tejet delikate të shoqërisë tonë, pra për të dënuarit që vuajnë dënimin me burgim në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Shqipëri. Rëndësia e saj nuk qëndron vetëm për faktin se prej disa viteve me rradhë nuk ka pasur amnisti, qysh prej janarit të vitit 2017, por konsiston në lirin e një pjese tejet të madhe të dënuarish 160 të tillë, prej të cilëve 21 gra dhe 1 i mitur.</p> <p>Lirimi i të amnistuarve u krye sipas planifikimit në orën 16.00 datë 3.3.2020 nga IEVP përkatëse. Dhënia e amnistisë u bë me qëllimin që të mund të sjellë një zhvillim pozitiv në raport me këta shtetas/e që lanë qelitë, për tu bashkuar me familjet e tyre, si dhe të shërbejë si një shembull konkret reflektimi për ta dhe me ndikim të drejtëpërdrejtë në risocializimin në shoqëri.</p>
3. Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të ndaluarve/ të burgosurve me probleme të shëndetit mendor.	DPB		62 629			Në proces	<p>3.1Në dhjetor 2019 një plan tranzitor masash është hartuar nga MSH dhe MD në kuadër të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave me masë mjekësore mjekim i detyruar. Zbatimi i planit u planifikua që të përbushet gjatë 2020.</p> <p>Si rezultat i situatës së jashtëzakonshme krijuar nga COVID 19 janë pezulluar procedurat e prokurimit nga APP. Në këto kushte nuk janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe përmbyllja e investimit sipas planifikimeve.</p> <p>3.2Kërkesa për rritjen e pagave të mjekëve është përfshirë në kërkesat buxhetore të DPB-së për vitin 2020-2022, duke marrë në konsideratë komunikimet zyrtare me MF dhe MD.</p>

4. Garantimi i respektimit të të drejtave të të burgosurve	SHKBB	Platforma E Trajtimet Te Ankesave E Konsoliduar		35 000			Në proces	<p>SHKBB:Për periudhën kalendarike, Janar – Mars 2020, në lidhje me masën e 1-rë, “Rishikimi i Kuadrit Ligjor”, nga SHKBB-ja, është përgatitur drafti mbi ndryshimin e ligjit për SHKBB-në, brenda afatit të caktuar në vitin kalendarik 2019 dhe ende nuk ka një njoftim për miratimin ose jo të ligjit për SHKBB-në.</p> <p>Edhe për periudhën Janar – Mars 2020, vazhdon sipas rasteve të paraqitura në SHKBB, trajtimi i ankesave të të burgosurve, familjarëve vazhdon me efikasitet të plotë nga sektori përkatës, i hetimit dhe Ankesave pranë SHKBB-së.</p> <p>Për periudhën Janar – Mars 2020, vazhdon plotësimi i databazave të rrjetit të brendshëm të krijuar nga vetë punonjësit sipas sektorëve me qëllim evidentimin dhe nxjerrjen e të dhënave statistikore.</p> <p>Akoma nuk kanë filluar procedurat për krijimin e (Web page-numër jeshil).</p> <p>MD:Në vijim të realizimit të kësaj mase dhe të zbatimit të VKM nr.837, datë 24.12.2019 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020” është parashikuar që të miratohet projektligji “Për funksionimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve” dhe Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për propozimin e tij.</p> <p>Aktualisht Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit ka hartuar projektligjin, i cili është ripunuar në kuadër të konsultimit dhe është në faze bashkërendimi. Mbetet e pritshme që projektligji të përcillet pranë Këshillit të Ministrave brenda katër muajorit të parë të viti 2020.</p>
--	-------	---	--	--------	--	--	-----------	---

Nën-objektivi 6/b: Përmirësimi i Shërbimit të Provës sipas standardeve evropiane dhe rritja e përdorimit të sanksioneve alternative

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Përmirësimi i infrastrukturës së Shërbimit	Sh. i Provës	30 % e infrastrukturës së përmirësuar / ofrim	33 400		889,600 lek		E realizuar	Shërbimi i Provës: Gjatë periudhës Janar 2020 – Mars 2020 është përfunduar rikonstruksioni i godinës

të Provës		më i mire i dënimeve alternative						ku kryen aktivitetin DPSHP dhe ZVSHP Tiranë. Janë krijuar kushtet optimale në disa ZVSHP në ofrimin më cilësor të mbikëqyrjes dhe përkujdesin e të dënuarve. Aktualisht stafi prej 25 punonjësish, i cili po trajnohet është i përhur në programin Suedez mbi Drejtësinë penale për të mitur. Programi aktualisht është ndërprerë për shkak të pandemisë. Fondet e shpenzuara për periudhën Janar 2020 - Mars 2020 janë në shumën 889,600 lek.
-----------	--	----------------------------------	--	--	--	--	--	--

Objekti 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë

Nën-objekti 7/a: Përmirësimi i procesit të hartimit të politikave, planifikimit dhe proceseve të vlerësimit të sistemit të drejtësisë

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Rritja e kapaciteteve planifikuese dhe monitoruese të Ministrisë së Drejtësisë me qëllim hartimin e politikave efikase mbi sistemin e drejtësisë dhe zbatimin e tyre.	MD, KM	Zbatimi sipas kalendarit të trajnimeve	3 000				Në proces	Në datë 13.2.2020, 3 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga KM, për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (RIA), me qëllim “të kuptuarit e kërkesave ekzistuese dhe zbatimin e standardeve për vlerësimin e ndikimit dhe konsultimin publik”; Objekt i trajnimit RIA, ishte projektligji “Për Arbitrazhin”. Në trajnim kanë qënë gjithashtu 2 specialistë nga kodifikimi dhe 1 nga sektori i buxhetit në MD. KM: Gjatë tremujorit janar 2020 - mars 2020, lidhur me sistemin IPSIS (Integrated Planning System Information System), ka patur zhvillimet e

								<p>mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Është mbikëqyrtur intensivisht zbatimi i kontratës dhe është komunikuar vazhdimisht me vendorin. 2. Pas njoftimit zyrtar të vendorit se është instaluar edhe versioni i fundit i aplikimit të platformës IPSIS, grupi i punës i AKSHI-it realizoi testimet e nevojshme për sistemin IPSIS, konfirmoi instalimin e plotë të komponentëve të sistemit IPSIS dhe lëshoi për vendorin “Installation Certificate” për aktivitetin/produktin e realizuar. <p>Në vazhdim po vijohet me fazën e Testimeve të Pranimi Operacional, pjesë e të cilave janë dhe Testimet e Pranimi nga Përdoruesi.</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. Gjatë muajve janar - shkurt 2020, grupi IPSIS shqyrtoi dhe miratoi manualet e përdoruesve të IPSIS, qoftë nga pikëpamja strukturore ashtu dhe në përmbajtje, duke i krahasuar me “Solution Design Document”. Manualet shërbejnë si bazë për procesin e Testimit për Pranimin nga Përdoruesi. 4. Manualet janë përkthyer në Shqip në pjesën më të madhe të tyre. 5. Gjatë muajit mars 2020 e në vazhdim po zhvillohen cdo ditë seancat e testeve të Pranimi nga Përdoruesi, ku po prezantohen nga vendori secili modul i sistemit dhe finalizohen proceset/business ëorkfloë të cdo dokumenti që prodhohet në sistem, nivelet e aprovimit si dhe rolet e përdoruesve. Seancat janë kryer nëpërmjet platformës ËB me ëebex, me pjesëmarrjen e gjithë stafit të DZHM, Drejtorisë Rregullatore të PMO, përfaqesues të MEPJ, të disa Ministrive dhe të konsulentëve të projektit, të cilët kanë qënë aktiv në cdo seance. 6. Situata e forcës madhore të pandemisë globale bëri të pamundur realizimin e të gjitha aktiviteteve të kontratës brenda afatit 31 Mars 2020. Në të njëjtën kohë, pas konsultimit të procedurës që duhet të ndiqet për finalizimin me sukses të projektit me Bankën Botërore dhe CFCU, nga Banka Botërore është dërguar me datë 30.03.2020 një shkresë CFCU, ku duke konsideruar faktin që data e përfundimit të projektit IPS është 30 Qershor 2020, si dhe situatën e pasigurt ku ndodhemi, këshillohet amendimi i të gjitha kontratave në proces deri në afatin e përfundimit të projektit IPS. Në shkresën e saj, Banka Botërore shton se është në pritje të dërgimit të draft
--	--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>amendimeve të kontratave për dhënien e “No objection”. Grupi i menaxhimit të kontratës pasi diskutoi lidhur me ecurinë/statusin aktual të aktiviteteve/produkteve të projektit IPSIS, rishikoi planin e zbatimit të projektit duke marrë në konsideratë faktorët që kushtëzojnë zbatimin e aktiviteteve brenda afatit aktual.</p> <p>Përsa më sipër, si dhe bazuar në nevojat dhe ecurinë e deritanishme të kontratës, si dhe konsultimin e procedurës që duhet të ndiqet për finalizimin me sukses të kontratës me Bankën Botërore dhe me CFCU, me 31 Mars 2020, nga AKSHI u dergua kërkesa zyrtare CFCU-se për zgjatjen e afatit të realizimit të kontratës “Supply and Installation of Integrated Planning System Information System (IPSIS) – LOT 2” si dhe “Support for the supervision of the IPSIS project contract, as well as for software/IT technical aspects” deri në 15 Qershor 2020.</p>
2. Krijimi i një sistemi për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator të legjisllacionit	KM, MD	Trajnime të vazhdueshme për punonjësit dhe për punonjësit e rekrutuar rishtazi.	1 500			Realizuar	<p>KM:Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) dhe për kontrollin e cilësisë të Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit, për projektligjet që vijnë për shqyrtim dhe miratim në Këshill të Ministrave, në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të konsultimit publik, kanë përfituar me mbështetjen e BE-së një asistencë teknike 1 vjeçare (nëntor 2019 – nëntor 2020) për përmirësimin e cilësisë së këtyre dy proceseve të rëndësishme.</p> <p>Gjatë muajit janar 2020, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, me qëllim rritjen e kapaciteteve brenda ministrive të linjës, të cilat hartojnë Raportet e Vlerësimit të Ndikimit, ka koordinuar me ministrinë për zgjerimin e Rrjetit të Përhershëm të RIA-s, duke shtuar numrin e anëtarëve nga cdo ministri, ku padyshim përfshihet dhe Ministria e Drejtësisë. Në muajin shkurt 2020 janë organizuar me mbështetjen e ekspertëve të asistencës teknike të BE-së, 4 (katër) seksione trajnimesh për këtë proces, me pjesëmarrjen e pothuaj të gjithë anëtarëve të Rrjetit të RIAs. Janë planifikuar edhe 3 seksione trajnimesh të tjera, të cilat për shkak të</p>

								<p>situatës së krijuar nga pandemia COVID_19, janë shtyrë deri sa situata të normalizohet dhe të mund të lejohen organizime trajnimesh.</p> <p>MD: Në datë 13.2.2020, 3 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga KM, për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (RIA), me qëllim “të kuptuarit e kërkesave ekzistuese dhe zbatimin e standardeve për vlerësimin e ndikimit dhe konsultimin publik”; Objekt i trajnimit RIA, ishte projektligji “Për Arbitrazhin”. Në trajnim kanë qënë gjithashtu 2 specialistë nga kodifikimi dhe 1 nga sektori i buxhetit në MD.</p>
Nën-objektivi 7/b: Përmirësimi i kapaciteteve të hartimit dhe analizës ligjore dhe për njoftimin dhe konsultimin publik								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 <i>(E realizuar / në proces / e porealizuar)</i>	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Përmirësimi i sistemit të njoftimit publik dhe konsultimit të legjislacionit	KM, MD	<p>Trajnim:</p> <p>-për plotësimin e regjistrit të konsultimeve;</p> <p>- trajnim për proceset e njoftimit dhe konsultimit</p>	2 400				Në proces	<p>MD:Në Ministrinë e Drejtësisë Koordinatori për Konsultimet Publike realizohet si detyrë nga specialist i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit. Në përbushje të detyrimit që buron nga "Udhërrëfytesa për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile" 2018 – 2020, Koordinatori për Konsultimet Publike, në Ministrinë e Drejtësisë, ka marrë pjesë në trajnimin një ditor të datës 12 Qershor 2019 për "Konsultimin Publik" të organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, si dhe janë hartuar raportet 3-mujore dhe 6-mujore të konsultimit publik në përputhje me raportimet sektoriale.</p> <p>KM: Në muajn janar 2020 u finalizua Udhëzuesi Metodologjik për Konsultimin Publik hartuar në bashkëpunim me SIGMA/OECD pas një procesi të gjatë konsultimi me ML dhe trajnimesh me fokus</p>

							<p>indetifikimin dhe adresimin e sfidave dhe problematikave. Udhëzuesi do të miratohet me UKM dhe do të shërbejë si instrumenti bazë i cili do të orientojë zhvillimin e procesit të konsultimit publik.</p> <p>Në bashkëpunim me Asistencën Teknike të siguruar në kuadër të Konsultimit Publik me mbështetjen e BE-së, gjatë muajt janar-shkurt 2020 janë organizuar 2 trajnime me fokus rritjen e kapaciteteve dhe ekspertizës të Koordinatorëve të Konsultimit Publik. Në muajt mars është mundësuar përzgjedhja e akteve prioritare për të cilat TA do të ofrojë "on the job" training.</p> <p>Drejtorja e Politikave dhe Sistemeve për Mirëqeverisje në Kryeministri koordinon dhe monitoron kryerjen e procesit të konsultimit publik nga ana e institucioneve nga pikpamja e realizimit të cilësisë së këtij treguesi si dhe të numrit të akteve që i nënshtrohen konsultimit publik. Për periudhën janar-shkurt 2020 rezulton që Ministria e Drejtësisë nuk ka patur akte objekt i konsultimit publik.</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

Nën-objektivi 7/c: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar sipas standardeve evropiane

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Forcimi i kapaciteteve të MD për të përgatitur rregullimin e legjisllacionit vendas sipas <i>acquis communautaire</i>	MD	Përcaktimi i akteve që do të përafrohen me afate konkrete në programin analitik të projekt akteve	1 500				E porealizuar	<p>MD:Aktualisht kjo masë është e porealizuar, pasi në 2 tetor 2019, një prej nëpunësve civil, për dy nga pozicionet në strukturën e miratuar, ka paraqitur dorëheqjen dhe gjatë periudhës së raportimit, ky pozicion është vakant.</p> <p>Për pozicionin tjetër, kontrata e punës përfundon në 15 mars 2020.</p> <p>Me vendimin nr. 229, datë 18.03.2020 të Këshillit të Ministrave "Për një shtesë në Vendimin nr. 586, datë 30.08.2020 " Për punësimin e përkohshëm të</p>

							studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, është shtyrë afati i kontratës deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit në pozicionet e shërbimit civil, ku këta studentë ekselentë janë punësuar. Sa i takon analizës për të përcaktuar legjislacionin që do të përafrohet, është kryer analiza e akteve që do të përafrohen dhe janë dorëzuar TOC.	
2. Rritja e kapaciteteve të departamentit të lidhur me donatorë të ndryshëm në MD.	MD		28500			Në proces	Për periudhën janar –mars 2020 stafi në Ministrinë e Drejtësisë që ka si detyrë funksionale projektet/donatorët kanë ndjekur: 1. Workshop- Raportimi orientuar drejt rezultatit në asistencen IPA me date 7-8 janar 2020; 2. Workshop mbi hartimin e dokumentit Strategic Responce ne kuader te IPA III me date 3 shkurt 2020;	
Nën-objektivi 7/d: Përmirësimi i funksionimit të MD dhe institucioneve të saj të varësisë								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
1. Përgatitja e aplikantëve birësues mbi procesin e birësimit me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve.	KSHB	Zhvillimi i seancave të këshillimit të aplikantëve birësues në grupe të ndara; Këshillim për 30 cifte aplikantësh	175 000		3 859		Realizuar	Gjatë periudhës Janar 2020 - Mars 2020, janë realizuar në total 3 (tre) seanca këshillimi, gjatë të cilave janë trajnuar dhe informuar mbi procesin e birësimit 6 (gjashtë) çifte /aplikantë për birësim. Buxheti i realizuar që i takon seancave të këshillimit të zhvilluara gjatë periudhës raportuese është në masën 3 859 (tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë. Seancat e këshillimit janë zhvilluar në varësi të numrit të aplikantëve për birësim gjatë vitit 2020.
2. Përmirësimi i legjislacionit të fushës së mjekësisë ligjore dhe akteve	IML		50				Në proces	Përsa i përket rishikimit të ligjit për Autopsinë, hartimin dhe miratimin e një projektligji mbi funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, informojmë se ato nuk janë të përfshira në Programin

të tjera nënligjore.								<p>e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020. Në planin e projektakteve që do të propozohen gjatë vitit 2020, të miratuar me vendimin nr. 837, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave është planifikuar që të propozohet vendimi për organizimin dhe funksionimin e IML, gjatë katërmujorit të dytë të viti 2020.</p> <p>Nga ana e tjetër, Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit do të japë kontribut në të gjitha nismat që do ndërmerren për rishikimin e projektakteve të përmendura më sipër, pasi të paraqitet kërkesa e motivuar për ndryshime në legjislacion dhe pasi nevoja e ndërhyrjeve të jetë të jenë vlerësuar nga strukturat përgjegjëse për politikën që ndiqen për institucionet e varësisë.</p>
3. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të IML nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës në IML, në ambientet spitalore (spitali QSUT) si dhe spitaleve në rrethe, në pajisje (laboratori ADN) dhe në stafin/personelin e institucionit.	IML	Pajisje për 6 Institucione Rajonale të Mjekësisë Ligjore. Forcimi sipas rekomandimit meve të vlerësimit.	12 040	255 000		0	E pa realizuar	<p>Instituti i Mjekësisë Ligjore:Nuk ka zhvillime për periudhën raportuese.</p>
4. Rishikimi i legjislacionit në lidhje me përmbartimin shtetëror	MD/DPP	Miratimi i ndryshimeve të ligjit Zbatimi i ndryshimeve ligjore.	50			0	Në proces	<p>MD: Në lidhje me këtë masë, sqarojmë se rishikimi i ligjit “Për Përmbartimin Shtetëror” nuk është përfshirë në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, i miratuar me VKM nr.837 datë 24.12.2019, por Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit do të kontribuojë ndaj çdo nisme që do të ndërmerret për ndryshimin e ligjit “Për Përmbartimin Shtetëror”, pasi ai të jetë vlerësuar nevoja e ndërhyrjeve nga struktura përgjegjëse për politikën që ndiqen për institucionet e varësisë.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit:Me ngritjen e grupit të punës dhe përfundimin e analizës mbi evidentimin e mangësive për tu adresuar në ndryshime është mundësuar realizimi i projektligjit për “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror”, miratimi i te</p>

								cilit është në proces.	
5. Përmirësimi i infrastrukturës së godinave të shërbimit të përbarimit shtetëror, infrastrukturës logjistike bashkëkohore (pajisje elektronike, pajisje zyre) dhe pajisja me automjete për kryerjen e detyrave me efektshmëri.	DPP	Zbatimi i investimit për përmirësimin e infrastrukturës së godinës së DPP dhe ZP Tiranë, Fier, Korçë, Lushnje e Berat; Gjirokastër, Krujë, Kukës, Lezhë, Mat, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tropojë, Dibër, Vlorë e Përmet 7.6 % e infrastrukturës logjistike (pajisje elektronike) e përmirësuar; 14% e infrastrukturës logjistike (pajisje zyre) e përmirësuar;	47 000; 6 250; 2 750 (*18); 10 000 (*19); 8 000; 6 000 (*20); 10 000; 4 000 (*21)	550 000				E përcaktuar	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit: Në Buxhetin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror për vitin 2020 nuk është miratuar fond për investime.
6. Përmirësimi i burimeve njerëzore në këndvështrimin profesional operacional dhe financiar.	DPP	78 PERMBARUES gjyqësor të trajnuar; Zbatimi i rikategorizimit të pagave të shërbimit. Miratimi i projekt propozimit dhe implementimi i organikës së shtuar	50 500			0		Në proces	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit me evidentimin e nevojave për trajnim ka planifikuar dhe miratuar programin e trajnimit për vitin 2020 për përbaruesit gjyqësor shtetëror. Dhe, me kalimin e gjendjes së epidemisë nga infeksioni Covid - 19, do të procedohet me gatimin e trajnimeve për përbaruesit gjyqësor shtetëror. Me identifikimin e nevojës për një trajtim financiar të përshtatshëm, në masë të mjaftueshme me natyrën e përgjegjësisë së funksionit të përbaruesit gjyqësor, shkallën e vështirësisë në përbushjen e tij, është bërë propozimet konkrete në projektligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”, miratimi i të cilit është në proces.

Objekti 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin

Nën-objekti 8/a: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve të lira Ligjore

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2020	Buxhetimi / Kosto ⁵ (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë		
<p>1. Rritja e performancës së drejtorive përgjegjëse për monitorimin e profesioneve të lira ligjore dhe të institucioneve të varësisë në MD, nëpërmjet:</p> <p>1.1 Ngritja e një programi trajnimi për drejtorinë përgjegjëse për monitorimin e profesioneve të lira.</p> <p>1.2 Ngritja e një programi trajnimi për drejtorinë përgjegjëse për monitorimin e institucioneve të varësisë, veçanërisht me fokus kontrollin e respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata.</p>	MD	Finalizimi i metodologjisë/manua lit të monitorimit të profesioneve të lira; Kontrolli transparent, bazuar në një metodologji të qartë për institucionet e varësisë; Kontrolli transparent, bazuar në një metodologji të qartë për profesione të lira.	8 900				Në proces	<p>MD: Numri total i punonjësve të Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit ka në strukturë 14 punonjës dhe aktualisht ka 3 vende vakante.</p> <p>Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira ka të parashikuar në Strukturë: 8 pozicione, ku gjatë periudhës janar-mars 2020 nuk janë plotësuar të gjitha vakancat. Janë dy vende të lira, përkatësisht pozicion specialist dhe Drejtor drejtorie.</p> <p>Përsa i përket Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Tjera të Varësisë ka në strukturë 2+1 pozicione, nuk ka vend vakant.</p> <p>Ndërsa në Sektorin e Monitorimit të Institucioneve të varësisë në fushën penale ka një vend vacant dhe është pozicioni i përgjegjës të sektorit.</p> <p>Nga Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, gjatë periudhës janar 2020 - mars 2020 stafi i sektori u ndryshua. Stafi aktual ka ndjekur trajnim për ndërmjetësimin në dt. 4-6 mars 2020 me tematikë “<i>Forcimi i sistemit të ndërmjetësimin në Shqipëri</i>”, organizuar nga Norvegjian Embassy, Berlin Center for integrative Mediation, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimin, Fondacioni i pajtimit të mosmarrëveshjeve.</p> <p>Në ligjin nr. 110/2018 “Për Noterinë”, është parashikuar në mënyrë eksplicite detyrimi i Ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse në miratimin e akteve nënligjore.</p>

⁵ * Buxhetimi i masave të profesioneve të lira ligjore do të mbulohet nga të ardhurat e vetë Dhomave, si ente private me vetëfinansim.

							<p>Në 2019 janë miratuar aktet, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Urdhër nr. 444 datë 30.09.2019, “Për miratimin e Kodit të Etikës profesionale të noterëve”; Urdhër nr. 445 datë 30.09.2019, “Për miratimin e statutit të Dhomës Kombëtare të Noterisë”; Urdhër nr. 214, datë 21.03.2019 të Ministrit të Drejtërisë, “Për rifreskimine dosjeve të noterëve dhe asistenteve, si dhe formularët përkatës të vetëdeklarimit”, së bashku me Urdhrin për ngritjen e grupit të punës që ndjek këtë proces. <p>Për periudhën janar 2020 - mars 2020: Nga ana e strukturave përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë është finalizuar hartimi i draft akteve. Hapi tjetër është dërgimi i tyre Dhomës Kombëtare të Noterisë për mendim.</p> <p>Për më tepër, është hartuar draft urdhri për miratimin e standarteve dhe metodologjisë së inspektimit të veprimtarisë së noterëve. Për realizimin e metodologjisë së inspektimit, janë impenjuar dhe ekspertë të Euralius. (në proces)</p> <p>Për hartimin e standarteve të kontrollit të institucioneve të varësisë, DDLLM është në proces.</p>
<p>2.Rritja dhe forcimi profesional i avokatëve në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve nëpërmjet konsolidimit të programeve trajnuese të ofruara nga Shkolla e Avokatisë;</p> <p>Program i Edukimit Profesional të ofruar nga Shkolla e Avokatisë për trajnimin e avokatëve në mbarë vendin.</p>	Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë	Organizim i i trajnimit vazhdues DUKE PERDUNDUAR TRAJNIMIN E TE GJITHE AVOKATEVE NE RRETHE.	7 000			Në proces	<p>DHASH: Në bashkëpunim me Euralius po punohet për përgatitjen e Rregullores së Trajnimit Vazhdues të Avokatëve si dhe Vlerësimi i nevojave të Avokatëve.</p>
<p>3. Ngritja e një programi specifik trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të</p>	Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë;	Përgatitja e moduleve të trajnimit mbi viktimat, dhe grupe të	3 000				<p>DHASH:Në bashkëpunim me Organizatën Terres des Homme është përgatitur Udhëzuesi mbi Aplikimin e Drejtësisë Restauruese dhe Masave të Shmangjis si dhe Moduli i Trajnimit të Avokatëve</p>

grupeve vulnerable veçanërisht për të miturit në konflikt me ligjin	Shkolla e Avokatisë Në bashkëpunim me Këshillin e Europës,	tjera vulnerabël Vazhdimi i organizimi të trajnimeve vazhduese mbi drejtësinë për të miturit;					Në proces	dhe Asistent Avokatëve mbi këtë Udhëzues. Trajnimet janë shtyrë për shkak të situatës së krijuar.
4. Ngritja e Qendrës së Trajnimeve për noterët në Republikën e Shqipërisë; 4.1 Vlerësimi i noterëve sipas krediteve	DHKN	Seanca trajnimi sipas programit të miratuar (gjithsej 4 seanca/vit) ; Vlerësimi i noterëve.		1 400			Në proces	DHKN: Për periudhën janar 2020 - mars 2020 raportohet se është ngritur Qendra e trajnimeve. Është caktuar edhe drejtoresha e kësaj Qendre. Deri më tani nuk kanë filluar vlerësimet me kredite për noterët.
5. Krijimi dhe funksionimi i sistemit elektronik N.I.S.A., që siguron lidhje online në kohë reale të veprimtarisë së noterit me shërbimet publike.	DHKN	Funksiona lizimi i plotë i sistemit		1 072 800			Realizuar	DHKN: Sistemi NISA funksionon rregullisht.
6. Përmirësimi i kuadrit ligjor pas hyrjes në fuqi të ndryshimit të ligjit mbi ndërmjetësimin	DHKNd	Rishikim i manualit të tarifave të shërbimit të ndërmjetësimit.		5 000			Ne proces	Është miratuar manuali i rishikuar i tarifave të ndërmjetësimit, në mbledhjen e përgjithshme të ndërmjetësve, dhe është dërguar për miratim në Ministrinë e Drejtësisë. DHKNd mbetet në pritje të këtij miratimi.
7. Ngritja e Dhomave vendore dhe ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit; 7.1 Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve nëpërmjet organizimit të trajnimeve fillestarë, të vazhduar dhe gjithashtu trajnim i trajnerëve	DHKNd	HAPJA E ZYRAVE, Trajnim fillestar; Trajnimi vazhduar (30 - 50 ndërmjetës)		53 030			Në proces	DHKNd: Është hapur Zyra e Tiranës dhe Zyra e Durrësit. Është realizuar trajnimi fillestar për ndërmjetësit dhe në vijim është parashikuar edhe trajnimi vazhdues në muajt tetor, nëntor, dhjetor 2020.
8. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për shërbimin e ndërmjetësimit në vend	DHKNd	Media; Fletëpalosje dhe broshura; Fushatë informuese në shkolla dhe universitete; Takime me institucione publike dhe jopublike, notere, avokatë, jurisë dhe ekspertë		3 000			Realizuar	DHKNd: Lidhur me realizimin e këtij objekti raportohet se janë realizuar fletëpalosjet dhe broshurat përkatëse të cilat janë shpërndarë gjatë fushatës informuese të ndërmarrë nga Dhoma, në shkolla dhe universitete. Janë zhvilluar edhe takime të tjera në funksion të arritjes së këtij objekti.

<p>9. Finalizimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor në fuqi, që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor gjyqësor privat, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi.</p>	<p>MD, Kuvendi, DHKPGJP</p>	<p>Nuk ka të parashikuar për 2020</p>	<p>Pa kosto shtesë, pasi përballohet me kontributin e stafëve përkatëse të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës.</p>				<p>Realizuar</p>	<p>Kuvendi i RSH:Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datën 08.05.2019 ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, i cili përmbylli edhe paketën e dytë të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë. Ky ligj ka për qëllim:</p> <p>a. adresimin e problematikave të evidentuar në analizën e sistemit të drejtësisë për shërbimin përbarimor gjyqësor privat;</p> <p>b. garantimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.</p> <p>c. hedhjen e bazave solide për zhvillimin e profesionit të përbaruesit gjyqësor dhe statusin e tij profesional, përgjegjësisë së tij ligjore, garancive të procesit përbarimor, marrëdhënieve institucionale, integritetit akademik të përbaruesve gjyqësorë në përputhje me standartet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.</p> <p>MD:Është miratuar në datën 08.05.2019 ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”.</p> <p>Në zbatim të ligjit të sipër cituar, aktet nënligjore janë draftuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër Ministri. Janë konsultuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe me ekspert të jashtëm.</p> <p>Pas përmbjlljes së kësaj faze. është dërgimi i tyre për mendim pranë Dhomës Kombëtare të Përbarimit Gjyqësor Privat.(ne proces).</p> <p>Në datën 08.05.2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, i cili përmbylli edhe paketën e dytë të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë. Ky ligj ka për qëllim:</p> <p>a) adresimin e problematikave të evidentuar në analizën e sistemit të drejtësisë për shërbimin përbarimor gjyqësor privat;</p> <p>b) garantimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.</p> <p>c) hedhjen e bazave solide për zhvillimin e profesionit të përbaruesit gjyqësor dhe statusin e tij profesional, përgjegjësisë së tij ligjore, garancive të procesit përbarimor, marrëdhënieve institucionale, integritetit akademik të përbaruesve gjyqësorë në përputhje me standartet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.</p>
---	-------------------------------------	---------------------------------------	---	--	--	--	------------------	---

								Nëpërmjet dekretit nr. 11195, datë 31.05.2019 Presidenti i Republikës vendosi kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”. Pas shqyrtimit të dekretit të Presidenti, Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 04.07.2019 vendosi rrezimin e dekretit të Presidentit të Republikës. Ligjë është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 99, datë 10.07.2019.
<p>10. Forcimi i kapaciteteve profesionale të përmbartuesve gjyqësorë privatë;</p> <p>10.1 planifikimi i trajnimeve sipas nevojave, mbështetur në analizën e ankesave dhe mangësi të konstatuara nga DHKPGJP dhe MD gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së përmbartuesve gjyqësorë privatë;</p> <p>10.2 Përgatitja e kurrikulave të trajnimit;</p> <p>10.3 Organizimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme (në varësi dhe të ndryshimeve ligjore);</p> <p>10.4 Përlllogaritje e kostove të funksionimit të qendrës së trajnimeve;</p> <p>10.5 Ngritjen e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.</p>	DHKPGJP, MD	(10.2 dhe 10.3) Rishikim periodik i kurrikulave të trajnimit, sipas nevojave në zhvillim. Qendra e Trajnimeve e pranë DHKPGJP -së, funksional e dhe në shërbim të trajnimit periodik të përmbartuesve.		7 000			E paraportuar	
11.1 Kryerja e një analize mbi nevojën e zgjerimit të aksesit në bazat e të dhënave shtetërore të shërbimit përmbartimor gjyqësor;	DHKPGJP, MD	Nuk ka të parashikuar për 2020		90 000			Në proces	MD: Në lidhje me masën 11.2, për periudhën janar 2020 - mars 2020 nuk ka marrëveshje të lidhura dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit.

<p>11.2 Nxitja e lidhjes së marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe për dhënie e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit;</p> <p>11.3 Ndërveprimi në kohë reale i sistemeve elektronike të shërbimit përmbartimor me sisteme të tjera shtetërore dhe baza të dhënash shtetërore dhe/ose me ente private.</p>							<p>Në lidhje me masën 11.3, nga ana e Drejorisë së Hartimit të Legjislacionit, është evidentuar si nevojë e përfshirjes së projektvendimit "Për përcaktimin e mënyrës së mbajtjes së regjistrat qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore" në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, i miratuar me VKM nr.837 datë 24.12.2019.</p> <p>Ky projektvendim është planifikuar të propozohet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave, gjatë katëmuorit të III-të të vitit 2020.</p> <p>Në lidhje me masën 11.3, nga ana e Drejorisë së Hartimit të Legjislacionit, është evidentuar si nevojë e përfshirjes së projektvendimit "Për përcaktimin e mënyrës së mbajtjes së regjistrat qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore" në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, i miratuar me VKM nr.837 datë 24.12.2019.</p> <p>Ky projektvendim është planifikuar të propozohet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave, gjatë katëmuorit të III-të të vitit 2020.</p>
<p>Nën-objektivi 8/b: Krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin</p>							
<p>Masat / Aktivitetet e parashikuara</p>	<p>Institucioni Përgjegjës</p>	<p>Targeti / Milestones 2020</p>	<p>Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019-2021</p>	<p>Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)</p>	<p>Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2020 (E realizuar / në proces / e përcaktuar)</p>	<p>Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2020</p>	

			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
1. Hartimi i kuadrit ligjor vendas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike me arbitrazh.	MD, Kuvendi	Njoftimi publik dhe ndërmjarrj a e aktiviteteve e njoftuese për zbatimin e zgjidhjeve me arbitrazh; Trajnime	2332				<p>MD:Në zbatim të Planit Analitik të Projekt-akteve që do të paraqiten për miratim gjatë vitit 2019 i miratuar me VKM nr. 764, datë 27.12.2018, institucioni përgjegjës për propozimin e kësaj nisme ligjore brenda katërmujorit të tretë të vitit 2019 është Ministria e Drejtësisë.</p> <p>Aktualisht Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit është duke përgatitur draftin “Për Arbitrazhin”.</p> <p>Janë mbajtur takime me përfaqësues të Euralius të cilët kanë paraqitur edhe një draft për këtë projektligj. Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në datë 16.09.2019 ka zhvilluar një tryezë konsultimi me përfaqësues nga Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, Zyrat e Avokatisë, përfaqësues nga grupet e interesit dhe shoqëria civile. Ky takim ka patur për qëllim diskutimin e çështjeve që janë vlerësuar si thelbësore mbi politikën që duhet ndjekur dhe që duhet të reflektohen në projektligjin “Për Arbitrazhin”.</p> <p>Është hartuar dhe vlerësuar nga Departamenti rregullator dhe i përuthshmërisë, pranë Kryeministrit, analiza e impaktit dhe projektligji është hartuar nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit.</p> <p>Projektligji është në fazë konsultimi publik, në regjistrin elektronik të konsultimit. Afati përfundimtar për mbylljen e konsultimit është 20 ditë pune nga momenti i publikimit në regjistrin elektronik të projektakteve, që përkon me mbylljen e afatit ligjor të konsultimit deri më datë 13 janar 2020.</p> <p>Paralelisht projektligji është përcjellë për konsultim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore.</p> <p>Aktualisht jemi në pritje të marrjes dhe shqyrtimit të komenteve. Pas përmbylljes së fazes së konsultimit projektligji do të ripunohet, në drejtim të komenteve të marra. Mbetet e pritshme që nisma të miratohet brenda katërmujorit të parë të viti 2020.</p> <p>Kuvendi i RSH:Roli i Kuvendit si në çdo nismë tjetër ligjore që paraqitet për shqyrtim dhe miratim është i lidhur me momentin e depozitimit të nismës</p>

